



Centre for Legal
Empowerment
www.cle.al



KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR



VEPRO@MJEDISI

E DREJTA MJEDISORE

Një manual i krijuar nga 5 studentë të Universitetit të Tiranës

Prill 2023

Deklarata e Mbështetjes:

“Ky projekt organizohet në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.”

Deklarata e Përgjegjësisë:

“Ky material është realizuar në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e organizatorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Kongresit Rinor Kombëtar apo Bashkisë Tiranë”.

***Kongresi Rinor Kombëtar (National Youth Congress - NYC)** është një organizatë

ombrellë e të rinjve - një bashkim i organizatave rinore, grupeve joformale, forumeve rinore të partive politike, me qëllim shkëmbimin e informacionit, nxjerrjen në pah të çështjeve të të rinjve, lobimin dhe advokimin për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe ngritjen e kapaciteteve për të gjitha subjektet e përfshira në rrjet. KRK u krijua në mars 2013 në Tiranë dhe numëron një antarësi mbi 120 organizata rinore aktive në të gjithë vëndin. Misioni i KRK është të mobilizojë organizatat rinore dhe të forcojë rolin e të rinjve në shoqëri që ata të kenë një zë të përbashkët për të mbrojtur dhe lobuar për çështje që i prekin.

****Titulli “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022” (Tirana European Youth Capital 2022)**, i cili do të zbatohet gjatë vitit 2022 nga Kongresi Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë i është akorduar Tiranës në kuadër të nismës European Youth Capital nga Forumi Rinor Evropian. Ky program sjell mundësi të reja, ndryshime pozitive, inkurajon pjesëmarrjen aktive, promovon identitetin evropian, diversitetin dhe përfshirjen, duke transformuar qytetin në një pikë ndërkombëtare takimi për të rinjtë.

Pasqyra e përmbajtjes

| | |
|---|----|
| Shkurtime, fjalë kyç | 3 |
| Ndryshimet Klimatike dhe kuadri ligjor | 4 |
| 1.1 Rëndësia e marrjes së masave dhe nismave ligjore për ndryshimet Klimatike..... | 4 |
| 1.2 Kuadri ligjor për ndryshimin e klimës në aspektin ndërkombëtar..... | 5 |
| E drejta e komuniteteve dhe organizatave jofitimprurëse për të adresuar në gjykatë raste të dëmtimit të mjedisit | 7 |
| 2.1 Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin kërkesë padi në gjykatë..... | 7 |
| 2.2 Pezullimi i zbatimit të aktit administrativ | 10 |
| 2.3 Paraqitja e çështjes në gjykatë | 12 |
| Raste nga praktika të dëmtimit të mjedisit nga ndërtimi i hidrocentraleve | 15 |
| 3.1 Litigimi Strategjik në fushën e Mjedisit | 15 |
| 3.2 Ndërtimi i HEC-eve Sekë dhe Zais..... | 16 |
| 3.3 Procesi I – Pavlefshmëria e akteve administrative të miratuara për HEC-et Sekë dhe Zais..... | 17 |
| 3.4 Procesi III - Shfuqizimi i licensës për prodhimin e energjisë elektrike të miratuar nga ERE..... | 21 |
| Ekonomia qarkulluese | 23 |
| 4.1 Ekonomia qarkulluese dhe konceptet mbi të | 23 |
| 4.2 Kuadri ligjor në mbështetje të ekonomisë qarkulluese | 26 |
| 4.3 Përparësitë në zgjedhjen e ekonomisë qarkulluese dhe mekanizmat e nevojshëm për ta mbështetur | 30 |
| 4.4 Ilustrimi i praktikave pozitive të ekonomisë qarkulluese | 32 |
| Ekonomia e gjelbër | 39 |
| 5.1 Ekonomia e gjelbër dhe konceptet mbi të..... | 39 |
| 5.2 Mekanizmat mbështetës të ekonomisë së gjelbër | 40 |
| 5.3 Praktika pozitive të ekonomisë së gjelbër..... | 43 |
| Ndryshimet Klimatike dhe Kuadri Ligjor | 46 |
| 6.1 Konferenca në Glasgow | 46 |
| 6.2 Marrëveshja e Parisit dhe rëndësia e saj | 47 |
| 6.3 Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm | 49 |
| 6.4 Krijimi i një pakete instrumentesh për integrim përshtatës ndaj Ndryshimeve Klimatike | 49 |
| 6.5 Kuadri ligjor dhe aktet nënligjore që duhet të miratohen. | 51 |
| 6.6 Rëndësia e krijimit të një strukture për Monitorimin Raportimin dhe Vlerësimin | 53 |
| 6.6 Reduktimi i shkarkimeve të GES..... | 54 |
| Referencat: | 55 |

Shkurtime

CDM - Clean Development Mechanism

CO₂ – Dioksidi i Karbonit

COP21- Konferencën e 21-të të Parisit për Ndryshimet Klimatike

GES – Green Energy Solution

GNPNK - Grupi Ndërmintorror i Punës për Ndryshimet Klimatike

IPCC - Intergovernmental Panel on Climate Change, Paneli Ndërkombëtar mbi Ndryshimet Klimatike

KKP - Kontributit Kombëtar i Pikësnyuar

KKP - Raportin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar

MRV – Monitorim, Raportim dhe Verifikim

MTM – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

NDA - Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar

NK – Ndryshimet Klimatike

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

PNNK - Panelit Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike

R.Sh. – Republika e Shqipërisë

SKNK – Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike

UNDP – United Nations Development Programme, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNEP - Programi i OKB-së për mjedisin Departamentin e Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike

UNFCCC - Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

VKM – Vendimi i Këshillit të Ministrave

Fjalët kyç

R.Sh., Klimë, Ndryshime Klimatike, GES, CO₂, Samiti Botëror Austriak, Konventa e Arhusit, Protokollin e Kiotos, Marrëveshjes së Parisit, Samiti i Sofjes, Marrëveshjes së Gjelbër për Ballkanin dhe Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë

Ndryshimet Klimatike dhe kuadri ligjor

1.1 Rëndësia e marrjes së masave dhe nismave ligjore për ndryshimet Klimatike.

Ngrohja globale ose ndryshimi i klimës është sot një ndër çështjet më të rëndësishme në agjendën ndërkombëtare. Kjo është një çështje globale jo thjesht mjedisore por edhe sociale, shëndetësore, ekonomike. Ndryshimi shumë i shpejtë i klimës apo kriza klimatike që po shohim këto dhjetëvjeçarët e fundit, është shkaktuar e po shkaktohet nga aktiviteti njerëzor i shkarkimit të gazrave serrë ku më të zakonshmit janë dyoksidi i karbonit (CO₂) dhe gazi metan (CH₄). Kjo ka sjellë një krizë klimatike, e cila është pasojë e ndotjes globale të atmosferës të shkaktuar nga njerëzim.

Sipas Panelit Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike (PNNK), ndryshimet klimatike janë “një ndryshim në gjendjen e klimës që mund të identifikohet (p.sh. me atë të testeve statistikore) nga ndryshimet në mesataren dhe/ose në tiparet e saj, dhe që vazhdon për një kohë të zgjatur, zakonisht për disa dhjetëvjeçarë ose më shumë. Kjo ka të bëjë me çdo ndryshim të klimës me kalimin e kohës, për shkaqe natyrale ose si rrjedhojë e aktivitetit njerëzor.”¹

Ndryshimet në dukje modeste të temperaturave gjatë shekullit të 20-të, janë shoqëruar me incidencë të rritur të përmytjeve dhe thatësirave, posaçërisht pas vitit 1970. Po kështu, gjatë shekullit të 21-të ndryshimi i klimës pritet të sjell rritje të frekuencave dhe intensitetit të motit ekstrem, rritje të nivelit të deteve dhe aciditetit të oqeanëve, zhvendosje të bimësisë dhe humbje të specieve në rrezik.

Shumë vende janë gjithnjë e më tepër nën ndikimin e ngjarjeve ekstreme të motit, si: përmytjet, periudhat me thatësirë, stuhitë dhe parametra të tjerë. Shkalla e ndjeshmërisë ndaj klimës përcaktohet pjesërisht nga ekstremet më të fundit të ndryshueshmërisë së klimës, si edhe nga ndjeshmëria e vendeve ndaj ngjarjeve përkeqësuese që ndikohen nga: përvojat e mëparshme, kushtet socio-ekonomike apo problemet e trashëguara nga e kaluara. Shkalla me të cilën ndjeshmëria ndaj motit ndikon në ekonominë e një vendi përcaktohet nga kapacitetet përshtatëse të tij.

Shqipëria është një nga vendet më të prekura në rajon prej ndryshimeve klimatike. Tendencat e ndryshimeve klimatike janë vënë re kryesisht gjatë 15 viteve të fundit me: rritjen e temperaturave, uljen e reshjeve dhe një shfaqje më të shpeshtë të fenomeneve ekstreme të motit, si periudhat me thatësirë dhe përmytjet. Parashikimet e klimës, paralajmërojnë ulje të sasisë së reshjeve në stinën e

¹ <https://iep-al.org/environmental-issues-in-albania/global-warming/?lang=sq>

verës me 10 % deri në 2020, dhe 20 % deri në vitin 2050. Dy sektorët më të ndikuar nga ndryshimet klimatike janë Energjia dhe Bujqësia.²

Qeveria Shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit ka mbështetur punën për hartimin e politikave mbi ndryshimet klimatike në dy shtylla kryesore, konkretisht nëpërmjet zbatimit të detyrimeve ndaj Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe zbatimit të detyrimeve në kuadër të integritimit Europian.

1.2 Kuadri ligjor për ndryshimin e klimës në aspektin ndërkombëtar

IPCC (Intergovernmental Panel on Climate Change) është organizmi ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara (OKB) për vlerësimin e shkencës së ndryshimeve klimatike. IPCC u krijua që të përpilojë në mënyrë sistematike për politik-bërësit, vlerësime shkencore për ndryshimet klimatike, ndërlikimet dhe rreziqet e ardhshme, dhe që të hartojë mundësitë për zbutje dhe përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike. Raportet e IPCC-së përpilohen nga mijëra shkencëtarë nga pothuajse të gjithë shtetet e botës. Dokumentet rishikohen e vlerësohen në një sërë fazash. IPCC është krijuar nga UNEP (Programi i OKB-së për mjedisin) në 1988-ën dhe ka 195 shtete anëtare.

Vendet e botës filluan me adresimin e ndryshimeve klimatike në vitin 1992 në Samitin e Rios në Brazil, ku u miratua një dokument që përmbante një plan për të stabilizuar përqendrimin e gazeve serë në atmosferë, në mënyrë që të parandalohen pasojat katastrofale për planetin. Dokumenti quhet **Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike** (UNFCCC) dhe hyri në fuqi në vitin 1994, pasi u nënshkrua nga 154 vende dhe u ratifikua nga Shqipëria në vitin 1995.

Tre vite më pas Ministria e Mjedisit, përgjegjëse për aspektet klimatike, krijoi **Departamentin e Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike** për të adresuar problematikën përkatëse, në koordinim me UNDP.

Samiti i fundit që është zhvilluar në kuadër të UNFCCC, për të vlerësuar ecurinë e shteteve në zhvillimin e politikave të ndryshme që ato kanë ndjekur mbi ndryshimet klimatike është **Samiti Botëror Austriak**. Konferenca e klimës u zhvillua në Vjenë, saktësisht 30 vjet pas Samitit të Tokës të vitit 1992 në Rio de Zhaneiro, ku u nënshkrua traktati i UNFCCC..”

² Monitorimi i strategjisë kombëtare për ndryshimet klimatike, 2020 – 2030 PËR 2019 – 2021, nëntor 2021

Konventa e Arhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’u drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, aderuar me ligjin Nr.8672, datë 26.10.2000, e cila është bërë pjesë e të drejtës së brendshme të R.Sh. Sa i takon zbatimit të saj, u miratua Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Arhusit. Nëpërmjet saj parashikohet rritja e rolit aktiv të publikut, shoqërisë civile, OJQ-ve dhe biznesit në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Në nenin 48 të Kushtetutës sanksionohet se kushdo mund t’u drejtojë ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara me ligj. Ndërsa e drejta e informimit sa i takon informacionit mjedisor, parashikohet në nenin 56 të Kushtetutës të RSh.

Përshtatja e Ligjit të ri Nr. 155/2020 “Për ndryshimet Klimatike” krahas masave konkrete teknike, parashikohen dhe masa për rritjen e edukimit qytetar dhe arsimor, nëpërmjet përfshirjes së programeve të posaçme, si dhe marrjen e masave për të realizuar informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, nëpërmjet fushatave të informimit për të sensibilizuar e ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike.

Në dhjetor të vitit 2004, qeveria ratifikoi **Protokollin e Kiotos** që synonte reduktimin ose kufizimin e emetimeve të gazrave të efektit serrë (GES) për vendet e Evropës Lindore me 24% nga viti bazë deri në vitin 2010³. Për të arritur objektivin e Konventës, u hartuan një sërë masash të cilat kanë të bëjnë me: rritjen e efikasitetit të energjisë; gjetjen, zhvillimin dhe përdorimin e formave të reja të shfrytëzimit të energjisë së rinovueshme; përdorimin e teknologjive inovative në aspektin mjedisor për eliminimin e dioksidit të karbonit. Aneksi i tij specifikon se 37 vende do të reduktojnë me 5.2% emetimin e gazeve serë, krahasuar me vitin 1991. Protokollin lejon aplikimin e “mekanizmave fleksibël”, për reduktimin e emetimit të CO₂ dhe krijimin e mekanizmave të zhvillimit të pastër (Clean Development Mechanism CDM). Çdo shtet pjesëtar i aneksit i duhet të hartojë dhe paraqesë një raport vjetor lidhur me çlirimet antropogjenike të gazeve me efekt serë.

Megjithatë, Shqipëria nuk arriti të përshtatë dhe adoptojë masa të tilla, qoftë në nivel kombëtar, qoftë në atë vendor. Në Shqipëri, ndikimet e ndryshimit të klimës kanë qenë kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe energjisë dhe pritet të rriten në të ardhmen .

³ Heyhoe, et al., 1998

Marrëveshja e Kopenhagenit konsiderohet si vazhdim i protokollit të Kiotos. Kjo marrëveshje përcakton “Ndryshimet Klimatike” si një ndër sfidat më të mëdha të kohës. Disa nga qëllimet e kësaj marrëveshje janë: masat paraprake të shteteve të cilët do të preken më shumë nga ndryshimet klimatike si dhe hartimi dhe miratimi i një programi të përbashkët ndërkombëtar veprimi. Nevojitet një bashkëpunim i ngushtë, në nivel ndërkombëtar me qëllim hartimin dhe adaptimin e masave urgjente për zvogëlimin e riskut si edhe rritjen e aftësive rehabilituese të vendeve në zhvillim, veçanërisht atyre që janë më shumë të kërcënuara, si vendet e pazhvilluar.⁴

Samiti i Sofjes më datë 18 nëntor 2020 dhe nënshkrimi i **Marrëveshjes së Gjellbër për Ballkanin dhe Planin Kombëtar për Energjin dhe Klimën**. Marrëveshja e Gjellbër do të ketë një rol të rëndësishëm në fuqizimin e bazës për mbrojtjen e mjedisit, duke shtyrë përpara vazhdimin e përpjekjeve të zhvillimit të qëndrueshëm, dekarbonizimin dhe tranzicionin e energjisë së pastër. Marrëveshja e Gjellbër Evropiane është pjesë e strategjisë së KE për zbatimin e Axtendës së Kombeve të Bashkuara për vitin 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Ajo ka për qëllim transformimin e BE-së në një shoqëri të begatë, me një ekonomi moderne, të efektshme në burime dhe konkurruese, e cila do të reduktojë shkarkimet neto të gazeve serë në zero, deri në vitin 2050 dhe ku rritja ekonomike është e pavarur nga përdorimi i burimeve. Synimi i saj është të mbrojë, ruajë dhe zgjerojë kapitalin natyror të BE dhe të mbrojë shëndetin dhe mirëqenien e shtetasve nga rreziqet dhe ndikimet e lidhura me ndryshimet në mjedis. Partnerët e Ballkanit Perëndimor do të mbështeten në përafrimin me Ligjin e ri të Klimës të BE -së, Skemën e Tregtimit të Emetimeve të BE -së si dhe reduktimin e emetimeve të CO2 përmes kuotave dhe mekanizmave të çmimit të karbonit.

E drejta e komuniteteve dhe organizatave jofitimprurëse për të adresuar në gjykatë raste të dëmtimit të mjedisit

2.1 Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin kërkesë padi në gjykatë

Çdo subjekt i të drejtës, në momentin që i drejtohet një gjykate të caktuar me një kërkim specifik, ka si detyrim fillestar dhe thelbësor, të provojë përpara gjykatës se ai ka një interes të ligjshëm për këtë çështje, e njohur dhe si “legjitimimi aktiv” në proces. Përballë legjitimitimit aktiv, është

⁴ Po aty.

“legjitimimi pasiv”, pra që padia duhet të drejtohet vetëm kundër atij, që me faktin ose me veprën e tij, mohon, zotëron ose shkel të drejtën e kërkuarit. Për çështjet mjedisore, ku aktet që kundërshtohen nuk i janë drejtuar drejtpërdrejt subjekteve që i kundërshtojnë këto akte, ka pasur mjaft vështirësi që publikut të gjerë dhe OJF-ve t’u njihet dhe pranohet legjitimimi aktiv. Për këtë arsye, vlerësohet se mënyra më e mirë për të argumentuar se çfarë përbën interes të ligjshëm në këtë kontekst, është nëpërmjet referimit të praktika gjyqësore të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, e cila e ka trajtuar çështjen e legjitimitit aktiv në 3 vendime të vitit 2021, duke u bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo siç njihet edhe si “Gjykata e Strasburgut”. Konkretisht, legjitimimi aktiv është trajtuar në një çështje me paditës 27 banorë të Njësisë Administrative Margegaj, qyteti Bajram Curri, Bashkia Tropojë, si dhe një OJF, “Shoqata Toka”, lidhur me ndërtimin e HEC-eve në luginën e Valbonës;⁵ në një çështje me paditës 53 banorë të fshatit Laknas, Bashkia Kamëz, si dhe një OJF, “Shoqata e Bujqësisë Organike”, lidhur me ndërtimin e një kompleksi bujqësor në një pyll në pronësi të Bashkisë Kamëz, i cili shfrytëzohej nga banorët si zonë e gjelbër pushimi dhe qëndrimi;⁶ dhe, çështja me paditës 3 OJF dhe një qytetar, lidhur me ndërtimin e Uzinës së Petëzimit dhe Shkrirjes në qytetin e Kurbinit.⁷

Gjykata e Lartë ka pranuar se, në interpretim të standardeve të parashikuara në Konventën e Aarhus-it dhe në legjislacionin shqiptar, e drejta për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit dallon nga rastet e tjera të mosmarrëveshjeve gjyqësore, ku palët i drejtohen gjykatës për të kërkuar rivendosjen e një të drejte të shkelur. Për shkak të natyrës së të drejtave të pretenduara të shkelura në çështjet mjedisore, vështirësohet plotësimi i një prej kushteve thelbësore të ngritjes së padisë, interesi i drejtpërdrejtë, pasi në këto çështje mbrohen të drejta më karakter të përgjithshëm.

E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është e pasqyruar në nenin 9, të Konventës së Aarhus-it, në të cilën parashikohet se “[...]

2. Çdo Palë, brenda kuadrit të legjislacionit kombëtar, do të sigurojë që anëtarët e publikut të interesuar që: (a) kanë interes të mjaftueshëm, ose (b) u është cenuar një e drejtë, në rast se ligji procedural i një Palë e kërkon këtë si parakusht, do të kenë të drejtën për një procedure shqyrtimi përpara gjykatës dhe/ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanëshëm, të krijuar me ligj, për të mos pranuar legalitetin substantive dhe procedural të çdo vendimi, akti ose lënie mënjanë, sipas

⁵ Vendimi nr. 1177, datë 21.07.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

⁶ Vendimi nr. 1259, datë 30.07.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

⁷ Vendimi nr. 2066, datë 23.11.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

klauzolave të nenit 6 dhe, kur kjo parashikohet në ligjin kombëtar dhe pa paragjykuar paragrafin 3 më poshtë, të klauzolave të tjera përkatëse të kësaj Konvente. Çfarë përbën interes të mjaftueshëm dhe cenim të një të drejte do të përcaktohet, në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe me objektivin për t'i dhënë publikut të interesuar të drejta me të zgjeruara për t'ju drejtuar gjykatës, brenda sferës së kësaj Konvente. Për këtë qëllim, interesi i një organizate jo qeveritare që plotëson kërkesat e referuara në nenin 2, paragrafi 5, do të konsiderohet i mjaftueshëm për qëllimin e nënparagrafit (a) me lart. Organizatat e tilla do të konsiderohen si organizata që kanë të drejta, të cilat u cenohen për qëllimet e nënparagrafit b me lart. Klauzolat e paragrafit 2 nuk do të përjashtojnë mundësinë e një procedurë shqyrtimi paraprak përpara një autoriteti administrativ dhe nuk do të ndikojnë kërkesën e shterimit të procedurave të shqyrtimit administrativ, përpara apelimit të procedurave gjyqësore të shqyrtimit, në rastet kur një kërkesë e tillë ekziston në ligjin kombëtar.

3. Përveç kësaj dhe pa paragjykuar procedurat e shqyrtimit, të referuara në paragrafët 1 dhe 2 me lart, çdo Palë do të sigurojë që, në rastet kur anëtarët e publikut plotësojnë kriteret, në se ka të tilla në ligjin kombëtar, ata do të kenë të drejtë për t'ju drejtuar procedurave administrative ose gjyqësore për të mos pranuar veprimet apo neglizhimet nga personat private dhe autoritetet publike, të cilat janë në kundërshtim me klauzolat e legjislacionit të vet kombëtar, në lidhje me mjedisin.”

Shtylla e tretë e Konventës së Aarhus-it përmban në vetvete tre elementë të rëndësishëm: 1. Gëzimin e legjitimitetit aktiv për të vënë në lëvizje gjykatën; 2. Realizimin praktik të së drejtës, duke shmangur kostot e larta të procesit gjyqësor; dhe, 3. Mundësinë që vendimi gjyqësor të rivendosë të drejtën e shkelur. Konventa parashikon se për të ngritur një çështje përpara gjykatës, personi duhet të ketë një interes të mjaftueshëm për çështjen ose t'i jetë cenuar një e drejtë. Konventa referon në legjislacionin kombëtar, në mënyrë që publikut t'i jepen të drejta më të zgjeruara për t'iu drejtuar gjykatës, për çështje që kanë të bëjnë me qasjen në informacion apo pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimarrjes.

Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në neni 15, shkronja “d”, parashikon se të drejtën për të paraqitur padi e ka çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik, nga një akt normativ ose nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj.

Bazuar në Konventën e Aarhus-it, dhe në ligjin nr. 49/2012, të ndryshuar, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se qytetarët dhe OJF-të gëzojnë legjitimitim aktiv në ngritjen e padive lidhur me çështjet mjedisore, për sa kohë provohet një “interes i mjaftueshëm” në çështjen konkrete, në rast se, në cilësinë e kërkuësve paraqiten një grup qytetarësh që preken nga vijimi i punimeve, të cilët janë banorë të zonës, si dhe organizata jofitimprurëse, të cilat kanë për qëllim të aktivitetit të tyre promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Për të provuar lidhjen e anëtarëve të komunitetit me projektin e kundërshtuar, mund të përdoret çdo mjet prove i nevojshëm: vërtetime nga gjendja civile; vërtetime pronësie; apo dokumente të tjerë të cilët e lidhin personin përkatës me zonën ku pritet të zhvillohet projekti.

2.2 Pezullimi i zbatimit të aktit administrativ

Edhe nëse bëhet një ankim në gjykatë ndaj një akti administrativ, si për shembull një vendimi, kjo nuk e pezullon zbatimin e aktit dhe efektet që ai sjell. Për këtë arsye, për të shmangur mundësinë e dëmeve të rënda dhe të menjëhershme, Kodi i Procedurës Civile dhe ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, u ka vënë kërkuësve në dispozicion mjete juridike të njohura si masa të përkohshme, ndër të cilat njihet marrja e masës së sigurimit të padisë, e cila është kërkuar nga paditësit edhe në vendimet e sipërcituara. Sigurimi i padisë, nënkupton marrjen e menjëhershme të një sërë masash praktike, përpara se çështja të shqyrtohet në themel – masa të cilat, janë të nevojshme për shmangien paraprake të rrezikut që mund të sjellë vënia në zbatim e vendimit të kundërshtuar, e cila do ta bënte realizimin e të drejtave dhe interesave e paditësit, të vështirë ose të pamundur.⁸ Një masë praktike, për shembull, mund të jetë pezullimi i punimeve të projektit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes nga gjykata.

Masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë efektivitetin e vetë mjetit kryesor, nga i cili ato varen; konkretisht padisë dhe ankimeve përkatëse në çdo shkallë gjykimi.

Edhe në këtë rast, për të kuptuar më mirë natyrën dhe kushtet e sigurimit të padisë, do t’u referohemi vendimeve të Gjykatës së Lartë në 3 çështjet e mjedisit të përmendura më lart.

Në mënyrë që gjykata të vendosë për marrjen e një masë sigurimi padie, duhet të analizojë ekzistencën e tre kushteve themelore:

⁸ Kola (Tafaj), F.; Vokshi, A. *Procedura Civile*. Pjesa I, Botimi II, Shtëpia Botuese: Albas, Tiranë, 2018, f. 300.

1. ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin;
2. nuk cenohet rëndë interesi publik;
3. nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi duhet të japë garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Gjykata e Lartë sjell në vëmendje se gjykimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë është një proces i shpejtë, ku gjykata nuk shqyrton dhe vlerëson të gjitha provat në mënyrë të hollësishme për të parë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuarit, nëse qëndron apo jo e drejta në themel të mosmarrëveshjes. Në gjykime të këtij lloji, gjykata vetëm heton nëse plotësohen këto kushte: “(a) *ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin e gjyimit të padisë, dhe (b) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.*” E kundërta ndodh në gjykimin e themelit të padisë gjatë të cilës gjykata, duke respektuar të gjitha normat procedurale, shqyrton në themel nëse ekziston apo jo e drejta e pretenduar nga paditësi, nëse kërkimet e tij janë të mbështetura apo jo në prova dhe në ligj.

Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin, dhe mungesa e cenimit të interesit publik, janë kushte që duhet të bashkë ekzistojnë, dhe të cilat përlligjin nevojën për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Ndërsa, dhënia e garancisë nuk është një kusht i domosdoshëm për caktimin e masës së sigurimit të padisë, por një kusht alternativ, i nevojshëm vetëm nëse do të vlerësohej nga gjykata si i përshtatshëm për rrethanat e rastit, që do të aplikohet kurdoherë së bashku me dy kriteret e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”.

Gjykata e Lartë thekson se mjedisi është një koncept ndër territorial, i cili i kalon kufijtë e një vendi. Mbrojtja e mjedisit përbën një kusht themelor për sigurimin e zhvillimit të shoqërisë dhe është prioritet kombëtar me qëllim trashëgimin e saj të padëmtuar ndër breza. Ndërhyrjet në mjedis, në eventualitetin e pranimit të padisë, janë pothuajse të pamundura ose shumë të vështira, dhe të kushtueshme që të kompensohen dhe riparohen me veprime dhe projekte të tjera. Kështu, në çështjen e pyllit në fshatin Laknas, Gjykata e Lartë çmoi se mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë, të atëçastshëm dhe gati të pakthyeshëm për interesat që mbronte pala paditëse ishte e qartë, pasi vënia në zbatim e vendimeve të kundërshtuara, kishte ndikim të drejtpërdrejtë, duke rrezikuar dëmtimin e pyjeve dhe mjedisit në përgjithësi.

2.3 Paraqitja e çështjes në gjykatë

Shqyrtimi gjyqësor i çështjeve mjedisore ka marrë vëmendje të shtuar vitet e fundit. Kjo, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Janë të shumta rastet e ankimeve pranë gjykatave të rëndësishme ndërkombëtare, duke përfshirë dhe Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), me seli në Hagë, Hollandë. Më 4 maj, 2006, Argjentina paditi Uruguay-n përpara GJND-së, duke pretenduar se nga ana e Uruguait ishin shkelur detyrimet që i ngarkohen këtij shteti në bazë të një traktati ndërkombëtar, *Statuti i Lumit Uruguay*. GJND-ja, në prill të vitit 2010, arriti në përfundimin se Uruguay kishte shkelur detyrimin e tij ndërkombëtar për të informuar Argjentinën mbi qëllimet e saj për të ndërtuar mullinj në lumin Uruguay. Megjithatë, gjykata nuk e pranoi kërkesën e Argjentinës për kompensim, sepse ajo nuk dha asnjë provë bindëse që shkarkimi nga mullinjtë ka ndikuar negativisht në cilësinë e ujit, ose në ekuilibrin ekologjik të lumit.

Menjëherë pas zjarreve shkatërruese të vitit 2017 në Portugali, katër fëmijë dhe dy të rinj nga zona e goditur nga zjarri, paditën 33 shtete anëtare të Këshillit të Evropës, përpara Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), me pretendimin se nuk kishin bërë mjaftueshëm për të luftuar krizën klimatike. Ata argumentuan se këto vende po dështojnë në marrjen e masave të duhura për të mbajtur nivelin e rritjes së ngrohjes globale, nën 1.5°C, që të përmbushin detyrimet e tyre ligjore në kuadër të Marrëveshjes së Parisit. Sa më sipër, ata argumentuan se kërcënohet e drejta e tyre për të jetuar, si dhe e drejta për një mjedis të mbrojtur dhe të shëndetshëm, të garantuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Praktika gjyqësore e GjEDNJ-së thekson vazhdimisht nevojën e marrjes së masave efektive të institucioneve lidhur me identifikimin, ndryshimin dhe përmirësimin e politikave dhe aspekteve të përshtatshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike.

Mosmarrëveshjet administrative në Shqipëri zgjidhen prej një sistemi të specializuar gjykatash administrative. Sistemi i gjykatave administrative është i përbërë prej gjashtë gjykatave administrative të shkallës së parë (në Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë) dhe një gjykatë apeli që gjendet në Tiranë. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022, është miratuar harta e re gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji korrik 2023, do të funksionojnë vetëm dy gjykata administrative të shkallës së parë, në Tiranë dhe në Lushnjë, dhe një Gjykatë Apeli Administrativ, e cila do të vijojë të jetë në Tiranë. Pranë Gjykatës

së Lartë, prej vitesh është ngritur dhe funksionon “Kolegji Administrativ”, i specializuar në gjykimin e çështjeve të juridiksionit administrativ.

Gjykata vendos nëse një akt administrativ apo veprim tjetër administrativ është i ligjshëm ose jo, kur këto vendimmarrje përcaktojnë apo ndikojnë mbi ushtrimin e të drejtës, detyrimeve dhe interesave ligjore të një personi fizik apo juridik siç kërkohet prej ligjit. Padia depozitohet në gjykatat administrative dorazi ose përmes postës.

Gjykimi pranë gjykatës administrative është një gjykim i mbështetur në akte dhe në shkresa. Megjithatë, pranë gjykatës mund të zhvillohen seanca gjyqësore me praninë e palëve, ku secila nga palët ka të drejtën të japë shpjegimet përkatëse mbi pretendimet, faktet dhe provat. Kur gjyqtari i caktuar me short, vlerëson se kërkesë padia e paraqitur plotëson kërkesat formale, vendos t’i komunikojë padinë dhe aktet, palëve të tjera në proces, duke u lënë një kohë të caktuar për të paraqitur prapësimet e tyre dhe provat përkatëse, nëse kanë të tilla. Pasi kryhet ky komunikim shkresor, gjykata fillimisht cakton një seancë përgatitore, nëse vlerëson se kjo seancë është e nevojshme, dhe më pas kalohet në seancë gjyqësore.

Në vendimin e saj, gjykata pranon padinë si të bazuar në ligj dhe në prova, ose e rrëzon atë si të pabazuar. Në lidhje me vendimmarrjen konkrete, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata administrative, me vendim përfundimtar vendos:⁹

1. Pranimin tërësisht ose pjesërisht të padisë:

- a) shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;
- b) ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ ose detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;
- c) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;
- d) detyrimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;
- e) konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ që nuk prodhon më pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë;
- f) saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik;
- g) detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit;

⁹ Sipas nenit 40, të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar.

- h) përcaktimin e organit që ka në kompetencën e tij zgjidhjen e çështjes konkrete, duke urdhëruar, kur është rasti, dhe shfuqizimin e aktit të nxjerrë nga organi jokompetent;
 - i) shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm;
 - j) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike.
2. Në të kundërt, gjykata vendos rrëzimin e kërkesë padisë kur vlerëson se veprimi administrativ apo akti nënligjor normativ është i ligjshëm dhe i bazuar. Gjykata vendos rrëzimin e padisë edhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta.

Në rastet kur projekte të caktuar janë vënë në zbatim, dhe mund të kenë sjellë pasoja të dëmshme konkrete në mjedis, individët dhe/ose OJF-të, mund të ngrenë edhe një “padi kolektive”, për shembull, ndaj një kompanie private, duke kërkuar në një gjykim civil apo administrativ, shpërblimin e dëmit të shkaktuar në komunitetin e tyre nga veprimtaria e kësaj kompanie. Në një rast të tillë, paditësit mund të pretendojnë dëme në shëndet, përkeqësim të cilësisë së jetës, kufizime në veprimtarinë e jetës së përditshme, apo edhe dëme pasurore, në rastin e bizneseve të vogla, që nuk kanë më klientë për shkak të ndotjes së zonës.

Raste nga praktika të dëmtimit të mjedisit nga ndërtimi i hidrocentraleve

3.1 Litigimi Strategjik në fushën e Mjedisit

Konventa e Aarhus-it "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit" është nënshkruar në 25 qershor 1998 në Konferencën e IV Ministrove "Mjedisi për Evropën" të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) dhe ka hyrë në fuqi në 30 tetor 2001. Kjo Konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000. Hyrja në fuqi e kësaj Konvente, ka shtruar rrugën për proceset e litigimit strategjik në gjykatë në fushën e çështjeve mjedisore. Pika e fortë e Konventës së Aarhusit qëndron në aftësinë e saj për të fuqizuar shoqërinë civile për të punuar me legjislatorin dhe zyrtarët qeveritarë si për ndryshimin procedura ashtu edhe thelbësor nëpërmjet kanaleve demokratike ekzistuese. Ka qenë pikërisht miratimi i kësaj Konvente i cili ka sjellë ashtu si edhe në vende të tjera dhe në Shqipëri, një rritje të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjet mjedisore fillimisht gjatë procedurave të konsultimit dhe informimit të publikut dhe gjatë viteve të fundit edhe në adresimin e projekteve të vlerësuara si të dëmshme në gjykatë.

Procesi gjyqësor strategjik, përfshin zgjedhjen dhe sjelljen e një çështjeje në sallën e gjyqit me qëllim të krijimit të ndryshimeve më të gjera në shoqëri, se thjesht zgjidhja e një mosmarrëveshjeje konkrete. Subjektet që sjellin procese gjyqësore strategjike duan të përdorin ligjin për të lënë një gjurmë të qëndrueshme përtej vetëm fitimit të çështjes në fjalë. Kjo do të thotë se këto çështje janë po aq të lidhura me efektet që do të kenë në grupe të mëdha të popullsisë, sa edhe me rezultatin përfundimtar të vetë rasteve.

Përpara se të merret vendimi për të ndërtuar një proces gjyqësor strategjik, ka shumë gjëra që duhet të mbahen parasysh. Duhet vlerësuar se cilat janë çështjet ligjore, cilat janë qëllimet që grupi përkatës kërkon të arrijë, kush mund ta paraqesë çështjen, kur mund të paraqitet çështjen, përpara cilit institucion do të adresohet çështjen. Këto çështje diskutohen më në detaje më poshtë, të ilustruara me raste konkrete të adresuara përpara institucioneve administrative dhe gjyqësore shqiptare.

Në vijim do të trajtohen disa nga çështjet kryesore gjyqësore lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve në vend, çështje të cilat janë ngritur në gjykatë, pikërisht duke u mbështetur në Konventën e Aarhusit dhe njohjen e publikut dhe OJF-ve si aktorë të rëndësishëm nga ky akt juridik.

3.2 Ndërtimi i HEC-eve Sekë dhe Zais

Rrethanat e çështjes

Shoqëria “Hydro-Project” shpk dhe shoqëria “Gener 2” shpk kanë lidhur në cilësinë e konçensionarit, me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kontratën e konçensionit Nr.7030 Rep., Nr.2134 Kol., dt.12.06.2013, të formës BOT, me qëllim realizimin e Hidrocentralit “Sekë”, në lumin e Urakës, të rrethit të Matit. Kjo kontratë është plotësuar në vijim, me anë të Kontratës Shtesë, me Nr.2247 Rep., Nr.1095 Kol., dt.18.08.2017. Tashmë autoriteti kontraktor është Minsitria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ndërkohë arsyeja kryesore e lidhjes së kësaj kontrate të dytë, është se konçensionari mori përsipër që të ndërtojë jo vetëm HEC-in Sekë, por edhe atë Zais. Këto dy HEC-e janë projektuar për t’u ndërtuar në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe në Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë.

Me VKM Nr.661, dt.31.10.2018, “Për zgjerimin e sipërfaqes së PK “Lurë” dhe krijimin e PK “Lurë-Mali i Dejës” është vendosur bashkimi i dy parqeve kombëtare dhe krijimi i një parku të vetëm “Lurë-Mali i Dejës”. Si rezultat i kësaj VKM-je, tashmë një pjesë e konsiderueshme e zonës në të cilën zhvillohet projekti për ndërtimin e HEC-ve, është pjesë e një parku kombëtar. Ky fakt konfirmohet si në dokumente shkresore, por është pranuar edhe nga palët e paditura gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë.

Banorë dhe ish banorë të zonës, të mbështetur dhe nga organizata jofitimprurëse me objekt veprimtaria mbrojtjen e mjedisit “EcoAlbania”, duke e konsideruar projektin tepër të dëmshëm në kuptim të mjedisit, ekosistemit dhe biodiversitetit të zonës, krahas rezistencës nëpërmjet protestave të shumta, ankesave, peticioneve, aktiviteteve ndërgjegjësuëse, një fushate shumë intensive mediatike, vendosën që ta ndjekin çështjen edhe në rrugë institucionale, fillimisht duke adresuar kërkesa, peticione dhe ankime pranë shumë institucioneve publike dhe më pas, duke mos gjetur asnjë zgjidhje duke ju drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykata kompetente që mbulon nga pikëpamja territoriale Bashkinë Mat.

Aktualisht ky projekt është përfunduar dhe HEC-et prodhojnë energji elektrike.

Për shkak të kompleksitetit të situatës juridike për ndërtimin e HEC-ve Sekë dhe Zais janë zhvilluar tre procese të ndryshme gjyqësore pranë gjykatës administrative.

3.3 Procesi I – Pavlefshmëria e akteve administrative të miratuara për HEC-et Sekë dhe Zais

Aktet administrative në gjykatë mund të goditen në dy forma, duke kërkuar që gjykata të shpallë pavlefshmërinë relative të tyre, apo duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute. Kërkimi për shfuqizimin e aktit administrativ, për shkak se është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore, por jo për çështje thelbësore, mund të bëhet brenda një afati të caktuar sipas përcaktimeve në ligje të posaçme ose brenda 45 ditëve, kur nuk ka një afat të tillë, sipas përcaktimit të ligjit për funksionimin e gjykatave administrative. Për raste të caktuara, kur nuk është e shprehur qartë e drejta e ankimit, afati mund të jetë deri në 1 vit. Ndërkohë pavlefshmëria absolute e një akti administrativ, që kërkohet kur shkeljet ligjore gjatë miratimit të aktit, janë kaq thelbësore, sa është njësoj sikur ky akt të mos ishte miratuar kurrë, mund të kërkohet në çdo kohë.

në rastet, kur afati i përcaktuar në ligj është tejkaluar, kërkimi për pavlefshmëri absolute është e vetmja mundësi për ta adresuar çështjen në gjykatë. Edhe në rastin e HEC-ve Sekë dhe Zais, si në shumicën e çështjeve mjedisore, kur banorët nuk janë të informuar menjëherë për aktet administrative, që do t'ju mundësonte adresimin në gjykatë të një kërkesë padie me objekt pavlefshmërinë relative të akteve administrative, atëherë padia në gjykatë u paraqit me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative të miratuara për këtë projekt.

Legjitimimi

Disa prej paditësave janë banorë të njësive administrative ku do të zhvillohet projekti, e vërtetuar kjo me anë të vërtetimit përkatës të njësisë. Ndërkohë disa prej tyre, janë ish banorë të cilët megjithëse aktualisht janë zhvendosur me banim në vende të tjera, kanë lindur në këtë zonë dhe kanë prona të paluajtshme në këtë zonë, prona të cilat rrezikojnë të pësojnë dëme të riparueshme nëse HEC-et Sekë dhe Zais do të realizohen. Për këtë ju paraqitën gjykatës provat përkatëse.

Qendra “EcoAlbania” është paraqitur në këtë proces si paditëse, në cilësinë një personi juridik të regjistruar pranë regjistrimit të OJF-ve, me objekt specifik të veprimtarisë së saj të fokusuar në çështjet mjedisore.

Argumentet për pavlefshmërinë e Deklaratës Mjedisore

Procesi i informimit paraprak dhe dëgjesat me publikun nuk janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore. Duke qenë se neni 17 i ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, përcakton se mendimi dhe komentet e publikut e të OJF-ve, të pranishëm në takim, **janë kriter i domosdoshëm**, gjatë procesit të vendimmarrjes së VNM-së, në momentin që ky mendim nuk është marrë sipas procedurave të përcaktuara në ligj, atëherë kjo Deklaratë është e pavlefshme. Seanca dëgjimore me publikun organizohet në **një vend të përshtatshëm, sa më pranë** vendndodhjes së projektit dhe jo më herët se **dita e 30^{te} kalendarike** nga data e njoftimit të AKM-së prej zhvilluesit. Në rastin në fjalë, dëgjesat me publikun janë zhvilluar në datën 11.01.2018 në qytetin e Rrëshenit, në Bashkinë Mirditë.

Personat të cilët kanë marrë pjesë në dëgjesën me publikun sipas të dhënave të vëna në dispozicion nuk janë banorë të njësisë administrative Derjan, megjithëse në listëprezencën e zhvillimit të dëgjesave publike, ata kanë nënshkruar si banorë të kësaj njësie administrative.

Në raportin e Vlerësimit të Thelluar në Mjedis të realizuar nga shoqëria zhvilluese, në fq.75 bëhet një përshkrim i njësive administrative të cilat preken nga projekti. Rezulton se për Bashkinë Mirditë, projekti prek një njësi administrative, përkatësisht atë Selitë, ndërkohë që për Bashkinë Mat prek 2 të tilla. Pra në mënyrë të natyrshme, ishte e pritshme që të zhvilloheshin dy dëgjesa me publikun, në të dyja Bashkitë, ose dëgjesa duhet të zhvillohej në Bashkinë Mat. Fakti që projekti zhvillohet në dy njësi të ndryshme administrative ngarkon zhvilluesin me përgjegjësi për të zhvilluar dy dëgjesa, apo të koordinohet në mënyrë të tillë që dëgjesat të plotësojnë kriteret e ligjit. Bashkia Mat, Njësia e qeverisjes vendore që është një nga autoritetet publike që organizon dëgjesën me publikun nuk rezulton që të jetë pjesëmarrëse vetë në dëgjesën me publikun. Në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur. Çka i përkeqëson edhe më shumë gjërat, është mungesa e Drejtorisë Rajonale e të Mjedisit Dibër në zhvillimin e dëgjesave me publikun.

a. Pavlefshmëria e Urdhërit Nr.25, dt.07.02.2019 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, “Për heqien nga fondi pyjor publik dhe zvogëlimin në vol të sipërfaqes prej 0.618 ha ...”

1. *Mungon VNM për pyllëzimin dhe shpyllëzimin.* Në këtë rast duhet të ishte bërë një tjetër vlerësim i ndikimit në mjedis dhe pasi të bëheshin studimet përkatëse, të aplikoheshin pranë AKM-së për VNM. Ligji ka parashikuar detyrimin për të bërë një vlerësim të ndikimeve që do të ketë në mjedis shpyllëzimi dhe masave që duhet të merren gjatë ripyllëzimit, në mënyrë që ndikimi i këtij procesi në mjedis të jetë minimal.

2. Heqia nga fondi pyjor është bërë pasi zona është shpallur park kombëtar. Pas miratimit të VKM-së Nr.661, është vendosur bashkimi i dy parqeve kombëtare dhe krijimi i një parku të vetëm “Lurë-Mali i Dejës”, një pjesë e konsiderueshme e zonës në të cilën zhvillohet projekti ka kaluar në zonë të mbrojtur. Në këto kushte Urdhëri Nr.25, dt.07.02.2019 i Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit është i pavlefshëm, pasi nuk lejohet miratimi i heqies nga fondi pyjor për zonat që janë pjesë e zonave të mbrojtura.
3. Zvogëlimi i zonave të mbrojtura mund të bëhet vetëm me anë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave. Urdhëri Nr.25, dt.07.02.2019 i Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit, është i pavlefshëm, pasi Ministria jo vetëm që ka miratuar një akt që vjen në kundërshtim me ligjin, por edhe një akt që tashmë nuk ka më kompetencë për ta miratuar, pasi miratohet nga Këshilli i Ministrave, kjo sjell pavlefshmërinë e këtij akti edhe në zbatim të nenit 109/a të K.Pr.Administrative.

b. Pavlefshmëria e Lejes së ndërtimit vjen për shkak të pavlefshmërisë së Deklaratës Mjedisore dhe e Urdhërit Nr.25, dt.07.02.2019 të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit, mbi të cilat është mbështetur leja e ndërtimit. Për më tepër, leja e ndërtimit që miraton ndërtimin e një objekti në zonë të mbrojtur është e pavlefshme.

c. Pavlefshmëria e miratimit nga AKZM. Neni 26 (c), në zonat e mbrojtura të kategorisë së II, ku bën pjesë dhe parku Kombëtar: c) janë të ndaluara ndërtimi i zonave urbane, i autostradave, hekurudhave, linjave të prodhimit të energjisë, si hidrocentrale, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë; ç) nuk lejohet ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura. Pra qartësisht veprimtaria e projektit të ndërtimit të HEC-ve Sekë dhe Zais është njëveprimtari e cila vjen në kundërshtim me statusin e ri të zonës, si park kombëtar “Lurë – Mali i Dejës”. AKZM dhe Ministria e Mjedisit në momentin e lëshimit të deklaratës i qëndrojnë faktit që në momentin që AKZM e ka dhënë miratimin, sipërfaqja ende nuk ishte e përfshirë si zonë e mbrojtur.

d. Pavlefshmëria e Lejes për Përdorim të Burimit Ujor miratuar me Vendim të Këshillit të Basenit Ujor Mat

Marrja e ujit të një lumi si ai Flim dhe lënia pa ujë e Kanionit të këtij lumi, përbën një nga shembujt më negativ të zhvillimit të projekteve të kësaj natyre, pasi lumi Flim, shkon i tëri me anë të një kanali derivues dhe pastaj me anë të një tuneli prej disa kilometrash gjatësi në një lum tjetër, atë të Urakës.

Kanioni i Flimit ose Kanioni i Zall Gjoçaj, të njohura dhe të mbrojtura si Monument Natyrore të kategorisë së tretë, nga Neni 17, pika 2, e ligjit për Zonat e Mbrojtura, përcaktohen si “monumente natyrore, ku zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, pra si territore të pashqetësuara”. Në Nenin 17 e 18, ligji shprehet tekstualisht se: “ndalohen ndryshimet e gjendjeve natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura”. Projekti i HEC-ve Sekë dhe Zaiz të Kanionit, do të prekë në mënyrë të drejtpërdrejtë 97% të sasisë ujore, duke ju lënë lumenjve vetëm rreth 2,5% të sasisë aktuale ose natyrore, çka përbën një rrezik real për zhdukjen e vetë lumit, por nga ana tjetër edhe për ndikime të pakthyeshme në të gjithë ekosistemin

Trupat përkatëse ujore sipërfaqësore, siç është lumi Flim dhe ai Urakë, si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor (që ngelet pa ujë) ndryshojnë rrënjësisht karakterin e tyre në krahasim me atë që është shpallur me legjislacionin përkatës nga autoriteti kompetent, duke u kthyer, jo një nivel më poshtë që quhet i mirë, as në atë i moderuar (mesatar), as në atë të keq, e as në atë shumë të keq, por ata dalin jashtë klase klasifikimi.

Vendimmarrja e Gjykatës

Gjykata ka vendosur në vendimin e saj: Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Argumentet kryesore të gjykatës janë të lidhura me faktin se edhe pse nga ana e autoriteteve publike, palë të paditura në proces, janë kryer disa shkelje, të provuara gjatë gjykimit, këto shkelje nuk janë të një natyre të tillë sa të sjellin pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve.

Statusi Aktual

Vendimi me të cilin u refuzua kërkesa për masë të përkohshme u ankimua në Gjykatën Administrative të Apelit dhe, pas disa seancash gjyqësore, procedurat u pezulluan për tre muaj për shkak të pandemisë. Në qershor 2020, Gjykata rifilloi punën dhe vendosi të rrëzojë pretendimet tona të paraqitura me padinë, pavarësisht se pranoi se kishte disa parregullsi dhe shkelje. Gjykata argumentoi se këto të fundit nuk mund të shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të procedurës. Vendimi përfundimtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë u ankimua në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në nëntor 2021, Gjykata Administrative e Apelit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe ndalimin e ndërtimit të HEC-it në Zais. Në mars 2022, Gjykata e Lartë vendosi pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Administrative të

Duke qenë se autoritetet publike të përfshira kanë konfirmuar se HEC-et po ndërtohen në një zonë të mbrojtur, avokatët, në emër të qytetarëve të përfshirë, kanë dorëzuar një peticion pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), duke kërkuar që të merren të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e Ligjit për Zonat e Mbrojtura. MTE nuk iu përgjigj kësaj kërkesë. Pas skadimit të afatit ligjor, avokatët dorëzuan dy padi të reja. Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit. Gjatë kësaj periudhe avokatët e CLE i ofruan asistencë ligjore komunitetit në bashkëpunim me EcoAlbania, ndërsa grupi informal ATA Kamza shërbeu si ndërmjetës dhe ofroi ekspertizën e tyre në kryerjen e aktiviteteve.

3.4 Procesi III - Shfuqizimi i licensës për prodhimin e energjisë elektrike të miratuar nga ERE

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të komunitetit dhe të OJF-ve të angazhuara në këtë çështje, të dyja HEC-et arritën të ndërtoheshin. Pas ndërtimit, subjekti aplikoi pranë ERE për t'u pajisur me licensë për prodhimin e energjisë elektrike. Në Fletoren Zyrtare Nr.171, dt.25.09.2020, është botuar Vendimi Nr.146, dt.10.09.2020, i Entit Rregullator të Energjisë, nëpërmjet të cilit është miratuar licensimi i shoqërisë "Seka Hydropower" shpk për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et Sekë dhe Zais.

Enti Rregullator i Energjisë është përcaktuar si organi kompetent për miratimin e licensës për prodhimin e energjisë elektrike. ERE vendosi rrëzimin e kërkesës së paraqitur, për rishikimin e licensës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et Sekë dhe Zais.

Në vijim komuniteti vendosi sërish që t'i drejtohet gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ licensë për prodhimin e energjisë elektrike.

Argumentet për bazueshmërinë e padisë

Dy HEC-et për të cilat pala e paditur ka miratuar licensën e prodhimit të energjisë elektrike, janë realizuar në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe në Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë. Me VKM Nr.661, dt.31.10.2018, është vendosur bashkimi i dy parqeve kombëtare dhe krijimi i një parku të vetëm "Lurë-Mali i Dejës". Si rezultat i kësaj VKM-je, tashmë, projekti i realizimit të dy HEC-ve shtrihet **2.08 km** brenda këtij parku kombëtar, duke e bërë të paligjshme çdo veprimtari që zhvillohet në këtë park.

ERE pranoi se shtyu procedurën administrative për të verifikuar statusin e zonës ku po ndërtohen HEC-et, duke pranuar se e ka një kompetencë të tillë. Megjithatë pavarësisht se ka bërë një verifikim të tillë, ajo sërish ka miratuar licensimin e dy projekteve të ndaluara në mënyrë kategorike, nga ligji për zonat e mbrojtura në zonë të mbrojtur, park kombëtar.

Pala e paditur ERE pretendoi se licensimi nga ana e ERE është formal dhe nuk ka të drejtë të kryejë verifikime, apo përmbushjen e akteve ligjore. Nëse ky pretendim do të ishte i vërtetë, atëherë ERE nuk do të dilte me një vendim, por me një konstatim të thjeshtë.

ERE është një organ vendimmarrës, i cili ka për detyrë ligjore të verifikojë dokumentacionin e paraqitur nga subjekti kërkues dhe të bëjë verifikimet përkatëse pranë autoriteteve publike, siç e detyron ligji dhe të refuzojë vendimmarrje që janë në kundërshtim flagrant me ligjin.

Ekonomia qarkulluese

4.1 Ekonomia qarkulluese dhe konceptet mbi të

Idetë për një ekonomi qarkulluese kanë një numër të madh autorësh, edhe pse termi është kryesisht i përdorur në shekullin XXI. Ndër autorët e parë që konsiderohet se kanë ndikuar në zhvillimin e konceptit të ekonomisë qarkulluese është Kenneth Boulding¹⁰, i cili parashtrroi idenë e një “ekonomie hapësinore”, që do të funksiononte duke riprodhuar rezervat fillestare të kufizuara të lëndëve të para dhe riciklimin e mbetjeve. Ky koncept ka pasur një evolucion në rritje mes akademikëve, politikëbërësve dhe komunitetit të biznesit për nevojën për të lëvizur drejt një modeli të ri ekonomik, në të cilin materialet dhe energjia nga produktet e hedhura në treg rifuten në të njëjtin sistem ekonomik¹¹. Për herë të parë, ekonomia qarkulluese është parashikuar në vitin 1990 nga Pearce dhe Turner. Në një periudhë të mëvonshme, koncepti mori një vëmendje gjithnjë e më të madhe dhe kjo u reflektua edhe në përkufizimet e ndryshme dhe të shumta të dhëna nga studiues të ndryshëm.

Pavarësisht përkufizimeve të ndryshme, nëse ne, sot do të arrinim drejt një përkufizimi që do të na qartësonte idenë e ekonomisë qarkulluese do ta përkufizonim atë:

“Ekonomia qarkulluese përqendrohet në riciklimin, minimizimin e burimeve të përdorura, ripërdorimin e inputeve fizike dhe përdorimin e mbetjeve si burim që çon në uljen e konsumit të burimeve kryesore.”

Modeli aktual botëror ekonomik ka qenë dhe është modeli linear ekonomik, i cili ka në bazën e zhvillimit të tij: "merr, prodho, hidh". Modeli linear ekonomik nënkupton që burimet nxirren, kthehen në produkte, përdoren dhe hidhen në formën e mbetjeve në mjedis, të cilat shpesh kërkojnë periudha të gjata kohore për t'u asgjësuar prej tij. Edhe pse ka qenë modeli mbizotërues në shekullin XX, modeli linear ekonomik shoqërohet me një serë pikash të dobëta që diskutohen në kuadër të kostove që ky model ka prodhuar:

¹⁰ Në vitin 1966.

¹¹ Lehmann et al., 2014; Fondacioni Ellen MacArthur, 2012.

Së pari, e analizuar në terma statistikore, 21 miliard ton e të gjitha materialeve që përdoren për të prodhuar produktet përfundimtare, humbasin gjatë procesit të prodhimit¹² (skarco, efikasitet e ulët, magazinim jo i duhur, etj.).

Së dyti, të dhënat nga Eurostat tregojnë për një humbje rreth 2.7 miliard ton nga 65 miliard që shënoi totali i inputeve të përdorura në Evropë në vitin 2010, në formën e mbetjeve¹³. Nga kjo sasi e humbur, më pak se 40% u riciklua apo u ripërdor në forma të tjera, kjo nënkupton që 60% e sasisë së mbetjeve nuk u përdor asnjëherë. Keqmenaxhimi i burimeve sjell ndikime të tjera negative dhe ky model pavarësisht se ka qenë më i mbështetur ka arritur në një fazë të zhvillimit të tij ku anët negative/pikët e dobëta tejkalojnë anët pozitive.

Të dhënat e organizmave kryesor ndërkombëtar tregojnë për një rritje të popullsisë dhe të mbetjeve të prodhuara në vitet në vijim. Numri i popullsisë globale¹⁴ parashikohet të arrijë në 9 miliard në vitin 2030. Kjo nënkupton ekzistencën e problemeve për të përmbushur kërkesat për produkte dhe shërbime të popullsisë. Paralelisht me rritjen e popullsisë, parashikohet një rritje e mbetjeve urbane me 70% në vitin 2050, krahasuar me vitin 2016¹⁵.

Mjaft problematike për mjedisin për shkak të mbetjeve që prodhon, shfaqet edhe industria e modës së shpejt ku ajo që përbën problematikën më të madhe për këto kompani është fakti se ka rreth 92 milion ton mbetje tekstile të prodhuara në vit dhe pritet që ky numër të arrijë në 134 milion ton deri në vitin 2030. Por, kjo nuk është problematika e vetme që industria e veshjeve sjell në mjedis. Një tjetër problematikë është edhe fakti se prodhimi i veshjeve sintetika sjell nevojën e prodhimit të tekstileve sintetike të cila kanë nevojë për një sasi të madhe energjie për t'u prodhuar.¹⁶

Edhe larja e rrobave depoziton rreth 500.000 ton mikrofibra në oqean çdo vit, ekuivalente kjo me rreth 50 bilion shishe plastike. Shqetësues është edhe fakti se industria e modës së shpejt përdor fibra

¹² Ellen MacArthur, 2013.

¹³ Eurostat, 2013.

¹⁴ Të dhënat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shkurt 2022.

¹⁵ Raporti i Bankës Botërore, 2017.

¹⁶ <https://earth.org/what-is-fast-fashion/>

sintetike si poliestra, najloni dhe akriliku të cilave u duhen vite për t'u shpërbërë.¹⁷ Një pjesë e mirë e veshjeve përfundojnë në landfille ku më problematike shfaqen vendet e kontinentit afrikan aty ku depozitohet një sasi e konsiderueshme mbetjesh. Landfilli i Dandorës përbën landfillin më të madh të Afrikës Lindore dhe një nga landfillet më të mëdha në botë. Rreth 2000 ton mbetje të pandara dhe të parregulluara depozitohen nga zonat e banuara dhe bizneset në të.¹⁸

Po aq problematike shfaqet edhe hedhja e baterive të përdoruara në mbeturina. Pavarësisht se në pamje të parë mund të mendohet se në fakt hedhja e baterive në mbeturina nuk sjell ndonjë efekt negativ, e vërteta qëndron se kimikatet që përbëjnë bateritë janë mjaft të dëmshme për mjedisin. Kur bateritë hidhen në mbeturina, destinacioni i tyre i radhës janë landfillet, aty ku këto bateri mund të rrjedhin. Kështu, kimikatet që janë në përbërje të baterive thithen nga toka apo edhe mund të kontaminojë ujërat nën dhe mbi tokësor. Kjo sjell rrezik si për gjallesat ujore edhe për vetë njerëzit të cilët rrezikojnë të konsumojnë ujë që është i kontaminuar me metale të rrezikshme për shëndetin. Bateritë me litium janë akoma më të rrezikshme duke qenë se në rastin kur mund të kemi përhapjen e zjarreve në landfille litiumi jep kontributin e tij në këto zjarre duke ndikuar në zgjatjen në kohë të djegies.¹⁹

Të dhënat e mësipërme dhe zhvillimi i vrullshëm i botës kërkon kalimin nga një ekonomi lineare në një ekonomi qarkulluese. Ekonomia qarkulluese përfshin ridizenjimin e produkteve për të qenë më të qëndrueshëm, të ripërdorshëm, të riparueshëm dhe të riciklueshëm, dhe për këtë arsye të mbahen në qarkullim për aq kohë sa të jetë e mundur duke rritur kështu ciklin e jetës së një produkti. Përdorimi i një produkti në një cikël më të gjatë krijon vlerë të shtuar pozitive në ekonomi dhe në të njëjtën kohë krijon më pak mbetje në mjedis. Përtej kësaj, do të thotë gjithashtu ndryshim i mënyrës së konsumimit dhe përdorimit të mallrave dhe shërbimeve, dhe ndryshimi i konceptit të konsumit si

¹⁷<https://earth.org/fast-fashions-detrimental-effect-on-the-environment/#:~:text=The%20environmental%20impact%20of%20fast,amounts%20of%20ëater%20and%20energy.>

¹⁸<https://www.textilemountainfilm.com/about#:~:text=These%20low%2Dgrade%20textiles%20are%20burned%20or%20landfilled.&text=Sprawling%20over%2030%20acres%20just,residents%20%26%20businesses%20is%20dumped%20here.>

¹⁹<https://gsiwaste.com/battery-recycling-is-important-for-environmental-health/#:~:text=As%20batteries%20corrode%2C%20their%20chemicals,could%20be%20ingesting%20dangerous%20metals.>

shoqëri. Në një ekonomi qarkulluese, kompanitë duhet që të projektojnë produktet e tyre në një mënyrë të tillë që ato të kenë mundësi të ripërdoren sa më shumë që të jetë e mundur.

Ekonomia qarkulluese funksionon mbi bazën e tri parimeve kryesore:

- Ruajtja dhe forcimi i kapitalit natyror;
- Optimizimi i produktivitetit të burimeve;
- Rritja e efektivitetit të sistemit.

Këto tre parime mund të përkthehen në gjashtë aksione që ndërmerren nga bizneset: Rigjenero, Ndaj, Optimizo, Riciklo, Virtualizo dhe Shkëmbe.

4.2 Kuadri ligjor në mbështetje të ekonomisë qarkulluese

Bashkimi Evropian (BE), ka vendosur si një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vetin, kalimin drejt ekonomisë qarkulluese. Mbështetja e kësaj iniciative duket qartë nisur nga programet dhe fondet e shumta që BE po alokon në këtë drejtim. Për më tepër, në këtë kuadër është përgatitur edhe një plan veprimi për një ekonomi qarkulluese, i cili hap rrugën për një Evropë më të pastër dhe më konkurruese. Përpjekjet e para për kalimin drejt një ekonomie qarkulluese filluan në vitin 2015 me miratimin e Planit të Veprimit për Ekonominë Qarkulluese²⁰. Ky plan synon kalimin nga modeli linear i ekonomisë drejt modelit qarkullues. Ky plan, i cili nxit inovacionin, konkurrueshmërinë dhe krijimin e vendeve të punës, është në përputhje me disa prioritete të BE-së, në fushat mjedisore, sociale, industriale, si dhe në linjë me parimet e krijimit të një ekonomie të qëndrueshme, pa karbon (carbon-free) dhe efikase në përdorimin e energjisë (energy efficient).

Komisioni Evropian miratoi planin e ri të veprimit të ekonomisë qarkulluese në Mars 2020. Kalimi i BE-së në një ekonomi qarkulluese do të zvogëlojë presionin mbi burimet natyrore dhe do të krijojë rritje të qëndrueshme dhe vende pune. Për më tepër ky plan veprimi është në të njëjtën linjë dhe me një parakusht për të arritur objektivin e BE-së për neutralitetin ndaj klimës në vitin 2050 dhe për të ndaluar humbjen e biodiversitetit. Plani i ri i veprimit shpall nisma përgjatë gjithë ciklit jetësor të produkteve. Në qendër të tij është mënyra se si projektohen produktet, promovon proceset e ekonomisë qarkulluese, inkurajon konsumin e qëndrueshëm dhe synon të sigurojë parandalimin e krijimit të mbeturinave dhe që burimet e përdorura të mbeten në ekonominë e BE-së për aq kohë sa

²⁰ Komisioni Evropian 2015.

të jetë e mundur. Plani ndër të tjera nënvizon se BE dhe Shtetet Anëtare duhet t'u mundësojnë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), që t'i kthejnë sfidat mjedisore në mundësi.

Ky plan mund të konsiderohet një ndër blloqet kryesore ndërtuese të Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, agjendën e re të Evropës për rritje të qëndrueshme. Marrëveshja e Gjellbër e BE-së është një nga 6 prioritetet e Udhëzuesit Politik të Komisionit Evropian për periudhën 2019 – 2024. Kjo Marrëveshje paraqet një sërë masash që synojnë krijimin e një ekonomie të qëndrueshme në BE, nëpërmjet përdorimit eficient të burimeve, uljes së ndotjes dhe reduktimit të emetimit të gazrave serrë, mbrojtjes së biodiversitetit dhe luftimit të ndryshimeve klimatike. E gjithë kjo nënkupton përqafimin e një modeli të ri ekonomik – modelin e ekonomisë qarkulluese. Akoma në ditët e sotme, ekonomia e BE-së mbetet më së shumti lineare. Vetëm 12% e materialeve të përdorura në industrinë e BE-së janë rezultat i riciklimit, ndërkohë që industria e BE-së përbën 20% të emetimit të gazrave serrë nga BE. Marrëveshja e Gjellbër e BE-së konsiston në një udhërrëfyes me masa afatshkurtra dhe afatmesme. Masat më afatshkurtra që trajton Marrëveshja e Gjellbër fokusohen në ndryshimet klimatike: krijimi i Ligjit Evropian të Klimës dhe ndryshime ligjore në legjislacionin relevant ekzistues, me qëllim arritjen e objektivave ambicioze të klimës së BE-së në 2030 dhe 2050 – uljen e mëtejshme të emetimeve të gazrave serrë deri në të paktën 50% për vitin 2030 (me synimin e mëtejshëm deri në 55%) dhe arritjen e objektivit të 2050 të BE-së për të pasur një klimë neutrale. Krijimi i Ligjit të parë Evropian për Klimën është një nga risitë më të rëndësishme të kësaj Marrëveshjeje. Ajo e kthen objektivin e klimës neutrale në 2050 në një objektiv ligjor, dhe me miratimin e këtij ligji, Vendet Anëtare do të duhet të marrin masa për zbatimin e tij. Por, arritja e objektivave të klimës nuk është e mundur pa kaluar në një model ekonomik qarkullues. Risia tjetër e kësaj marrëveshjeje është propozimi i një mekanizmi të rregullimit të kufirit të karbonit. Ky mekanizëm vjen si nevojë e kontrollit të rrjedhjeve të karbonit në sektorë të veçantë për shkak të diferencave në objektivat e një ekonomie pa karbon mes vendeve të ndryshme në botë.

Me rëndësi për t'u theksuar është edhe përfshirja e Ballkanit Perëndimor në këtë Marrëveshje, nëpërmjet planifikimit të një Axhende të Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Marrëveshja e Gjellbër rikonfirmon perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor duke e bërë atë një pjesë të pandashme të një plani ambicioz ekonomik, mjedisor dhe social. Në kuadër të sa më sipër dhe me synim

përshpejtimin e masave dhe veprimeve për Klimën dhe Mjedisin në Ballkanin Perëndimor, Bashkimi Evropian po mbështet zbatimin e Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Axhenda e Gjelbër përbëhet nga 5 shtylla kryesore si:

1. Veprimi për Klimën: dekarbonizimi, energjia, lëvizshmëria;
2. Ekonomia Qarkulluese: mbetjet, riciklimi, prodhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve;
3. Biodiversiteti: mbrojtja dhe ripërtëritja e natyrës;
4. Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës;
5. Sisteme të qëndrueshme ushqimore dhe zonat rurale.

Nëpërmjet Axhendës së Gjelbër²¹, në kuadër të kapitullit për Ekonominë Qarkulluese do të ndërmerren këto nisma për të siguruar arritjen e objektivave të vendosur:

- Mbështetje për të promovuar qëndrueshmërinë e prodhimit të lëndëve të para;
- Angazhim për integrimin e Ballkanit Perëndimor në zinxhirët e furnizimit industrial të BE-së, në veçanti për ekosistemet kryesore industriale të tilla si energjia e rinovueshme, tekstilet, turizmi, lëvizshmëria, industritë me energji intensive;
- Mbështetje për zhvillimin e strategjive për Ekonominë Qarkulluese, duke konsideruar të gjithë ciklin jetësor të produkteve, parandalimin e gjenerimit të mbetjeve, menaxhimin dhe riciklimin e përparuar të mbetjeve, ripërdorimin, riparimin dhe riprodhimin;
- Nisma ndërgjegjësuëse për konsumatorët në lidhje me mbetjet, ndarjen e tyre dhe konsumimin e qëndrueshëm;
- Asistencë në përgatitjen dhe zbatimin e programeve për parandalimin e mbetjeve, menaxhimin të mbetjeve, strategjisë së riciklimit, dhe programeve për ripërdorimin, riparimin dhe prodhimin;
- Vazhdimi i mbështetjes për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës të menaxhimit të mbetjeve;

²¹https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-01/C_2021_9730_F1_ANNEX_EN_V1_P1_1674669.PDF

- Zhvillimi i një marrëveshje rajonale për parandalimin e ndotjes nga plastika, përfshirë në mënyrë specifike trajtimin e mbetjeve detare;
- Mbështetje për hartimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovacionit në ekonomi, përmes zbatimit të “Smart Specialisation Strategies”.

Ekonomia qarkulluese edhe për vendin tonë përbën një çështje me rëndësi të veçantë duke qenë një nga komponentët e veçantë të integritit në BE dhe më saktësisht është pjesë e kapitullit 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”. Në kuadër të procesit të negociatave, Shqipëria do të duhet të përafrojë legjislacionin dhe në këtë drejtim dhe që kjo të arrihet do të duhet që palët e interesuara të përfshihen dhe të informohen mbi përfitimet dhe problematikat e këtij procesi dhe sesi bizneset mund të përfitojnë nga ky transformim. Koncepti i ekonomisë qarkulluese është përdorur më herët në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (2018-2023). Ajo është zhvilluar mbi vizionin ose perceptimin e konceptit të "zero mbeturina", në mënyrë që mbeturinat të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë të para dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve qarkulluese, duke i shërbyer kriterit të përdorimit dhe ruajtjes së burimeve të lëndëve të para.

Në Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve 2020-2035, qëllimi kryesor, i përmendur në fillim të dokumentit, është kalimi nga ekonomia lineare në atë qarkulluese. Në bazë të dokumentit, mbledhja e mbeturinave, trajtimi si lëndë e parë si dhe menaxhimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomisë qarkulluese. Në progres raportin e vitit 2021 thuhet se Shqipëria tregon një nivel përgatitje, por përparimi është i pakët për përafrimin e mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit me Acquis e BE-së, në disa fusha përfshirë menaxhimin e mbetjeve dhe rekomandon përsheptimin e zhvillimit të kapaciteteve për agjencitë kombëtare.

Megjithatë kuadri ligjor aktual, duke përfshirë rregulloret kombëtare dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe planet e veprimit, nuk siguron bazën për zbatimin e konceptit të ekonomisë qarkulluese në vend. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente për përmirësime në kuadrin aktual ligjor që do të rrisë aftësinë e vendit për të shfrytëzuar më mirë burimet e tij dhe ciklin jetësor të materialeve, produkteve dhe shërbimeve. Trajtimi i ekonomisë qarkulluese vetëm përmes çështjeve të menaxhimit të mbeturinave tregon se koncepti i ekonomisë qarkulluese është ende në fazat e tij të hershme.

4.3 Përparësitë në zgjedhjen e ekonomisë qarkulluese dhe mekanizmat e nevojshëm për ta mbështetur

Ekonomia qarkulluese është një sistem ekonomik që synon minimizimin e mbeturinave dhe shfrytëzimin më intensiv të burimeve. Në sistemin e ekonomisë qarkulluese inputi i burimeve dhe mbeturinat minimizohen duke i përdorur më me efikasitet. Kjo gjë arrihet përmes modelimit, mirëmbajtjes, riparimit, ripërdorimit, rindërtimit, rinovimit dhe riciklimit të zgjatur, gjë që është në kontrast me ekonominë tradicionale lineare. Modelet e ekonomisë qarkulluese të biznesit mund të jenë po aq fitimprurëse sa modelet lineare, duke i lejuar konsumatorët të vazhdojnë të kenë produkte dhe shërbime të ngjashme madje edhe më të mira se më parë.

Përdorimi i ekonomisë qarkulluese shoqërohet me shumë përfitime, si:

- një reduktim të ndikimit negativ në mjedis.
- rritja e efikasitetit në përdorimin e burimeve, i siguron kompanive një performancë më të lartë financiare.
- një model i tillë biznesi nxit konkurrueshmërinë dhe si rezultat edhe zhvillimin e metodave më inovative të prodhimit.
- krijon mundësinë e hapjes së vendeve të reja të punës duke rritur në këtë mënyrë normën e punësimit, si dhe nxit rritjen ekonomike.
- kursime të konsiderueshme të materialeve dhe ulje e ekspozimit ndaj paqëndrueshmërisë së çmimeve.
- rritje e qëndrueshmërisë: Ekonomia qarkulluese, duke lëvizur shumë më tepër materiale biologjike përmes procesit të tretjes dhe kthimit përsëri në tokë, do të zvogëlojë nevojën për rimbushje me lëndë ushqyese shtesë.

Pavarësisht gjithë përfitimeve që sjell zbatimi i ekonomisë qarkulluese, kalimi nga një ekonomi lineare në atë qarkulluese përballet me një sërë sfidash.

- Kosto të larta: Financimi i modeleve të reja të biznesit e bën tepër të kushtueshëm gjithë procesin e transformimit drejtë një modeli biznesi të ekonomisë qarkulluese.

- Rezistenca ndaj ndryshimit: Kulturat statike dhe konservatore të biznesit pengojnë transformimin e biznesit, duke kufizuar angazhimin në modelin e ekonomisë qarkulluese. Modelet ekzistuese të biznesit mund të mos jenë aspak të orientuara drejt ekonomisë qarkulluese dhe për këtë arsye do të duhet që biznesi të ndërmarrë ndryshime në terma afatgjatë.
- Perceptimi për një mungesë të kërkesës konsumatore: Ka një mungesë të ndërgjegjësimit të grupeve të ndryshme në lidhje me përfitimet që sjell ekonomia qarkulluese. Në këtë kuadër, bizneset si dhe grupet e tjera të interesit perceptojnë që një model i tillë biznesi nuk do t'u sjellë më tepër klientë, duke konsideruar edhe faktin se produktet e prodhuara nga një model i tillë janë më të shtrenjta.

Ashtu si u parashtrua më sipër përparësitë e ekonomisë qarkulluese janë të shoqëruara dhe me sfidat për realizimin e saj, dhe për këtë është e nevojshme ngritja e mekanizmave që mbështesin zhvillimin e ekonomisë qarkulluese, si:

- Ngritja e një kornize të qartë politikash dhe shkëmbimi të praktikave më të mira për të mbështetur këtë kalim.
- Ngritja e sistemeve financiarë të mbështetjes nga ana e qeverive për të nxitur NVM për të mbështetur ekonominë qarkulluese.
- Ngritja e rrjetit të këshillimit dhe mbështetjes praktike, teknike dhe ligjore. Politikëbërësit duhet së pari të kuptojnë më mirë problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen NVM në mënyrë që të zhvillojnë kornizat e duhura të politikave mbështetëse. Është e rëndësishme që të përcaktohet problemi në mënyrë që zgjidhja që do të gjendet të jetë sa më efektive.
- Ngritja e platformave që promovojnë praktikat pozitive të ekonomisë qarkulluese dhe krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit dhe ndërveprimit midis NVM dhe institucioneve shtetërore dhe NVM.
- Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorit për produktet që vijnë nga proceset e ekonomisë qarkulluese. Ndërgjegjësimi konsumator mund të ketë një efekt motivues të NVM-ve për të thithur një grup specifik klientësh, grup i cili do të ketë një ndikim të madh nëse është në rritje të vazhdueshme.

4.4 Ilustrimi i praktikave pozitive të ekonomisë qarkulluese

Praktika pozitive ndërkombëtare

Holanda – shteti që mbështet ekonominë qarkulluese dhe të gjelbër është në pararojë të ekonomisë qarkulluese në Evropë. Ajo njihet për tërësinë e aktiviteteve dhe iniciativave që ka ndërmarrë në kuadër të avancimit të ekonomisë qarkulluese. Një nga iniciativat më të njohura dhe të rëndësishme të qeverisë holandeze, është përgatitja e strategjisë kombëtare “Një ekonomi qarkulluese në Holandë deri në vitin 2050”, e cila është zhvilluar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, në vitin 2016. Programi përcakton masa që synojnë zhvillimin e një ekonomie qarkulluese deri në vitin 2050 duke përfshirë: objektivin për të zvogëluar përdorimin e lëndëve të para me 50% në vitin 2030 dhe të bëhet gati 100% ekonomi qarkulluese deri në vitin 2050. Për më tepër, Holanda ishte i pari vend që prezantoi “Marrëveshjen e Blerjeve Qarkulluese”, një iniciativë që nxit bashkëpunimin midis organizatave dhe inkurajon blerjen e produkteve që mund të riciklohen ose përdoren për një kohë më të gjatë. Në përputhje me direktivën e BE për TVSH-në për uljen e saj në kuadër të ekonomisë qarkulluese, Holanda gjithashtu ofron ulje të TVSH-së në lidhje me shërbimet e riparimit, veçanërisht për biçikleta, këpucë dhe produktet e lëkurës apo produkte të dorës së dytë. Në vitin 2017 më shumë se 80 organizata biznesi duke përfshirë edhe qeverinë, nënshkruan një marrëveshje me angazhimin për të kontribuar në strategjinë kombëtare të ekonomisë qarkulluese²².

Pakti i plastikës-më shumë produkte plastike por me më pak plastikë – 60 organizata në Holandë nënshkruan Paktin e Plastikës. Në këtë pakt ata bien dakord që deri në vitin 2025 do të përdorin 20% më pak plastikë dhe do të prodhojnë produkte plastike në atë mënyrë që gjithmonë të mund të riciklohen. Përveç kësaj, ata do të prodhojnë më tepër plastikë duke përdorur material biologjik për të siguruar më pak mbetje plastike si dhe një mjedis më të mirë dhe më pak emetime të CO₂²³

Suedia – ishte shteti i parë që ka miratuar një ligj për mbrojtjen e mjedisit në vitin 1967, dhe në vitin 1972 Suedia ishte vendi në të cilën u organizua konferenca e parë e Kombeve të Bashkuara mbi

²² <https://ecopreneur.eu/wp-content/uploads/2019/05/Ecopreneur-Circular-Economy-Update-report-2019.pdf>

²³ <https://www.circulairondernemen.nl/library/plastic-pact-nl-mr-met-minder-plastic-1>

mjedisin global. Që atëherë Suedia ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të zhvilluar një ekonomi qarkulluese nëpërmjet reduktimit të emetimeve të karbonit dhe limitimit të ndotjes.²⁴

Nga ana tjetër, edhe niveli i mbetjeve të ricikluara në Suedi ishte mjaft i lartë. Në vitin 2009, një person ka ricikluar rreth 17 kg mbetje, krahasuar me një kilogram që riciklohej para 10 vitesh.²⁵

Megjithatë, faktori më i rëndësishëm që e bën Suedinë një nga shtetet më miqësore ndaj mjedisit lidhet me rrënjët e forta të shtetit në inxhinjeri dhe teknologjinë industriale, e kombinuar kjo me një ndërgjegjësim të lartë të popullsisë. Fakti që suedezët e duan natyrën dhe mënyrën e tyre natyrore të jetuarit, përbën një faktor të shtuar për sa më sipër. Madje, edukimi fillon që në parashkollor, ku fëmijët mësohen të ndajnë llojet e ndryshme të mbetjeve, me qëllim për t'i bërë ata qytetar të denjë dhe të ndërgjegjësuar.²⁶

Japonia – është një nga shtetet model për sa i përket mbrojtjes së mjedisit dhe përqasjes ndaj ekonomisë qarkulluese për shkak të nivelit të lartë të ndërgjegjësimit të popullsisë. Qeveria japoneze ka ndërmarrë angazhimin për të kthyer tërësisht ekonominë e saj në ekonomi qarkulluese brenda vitit 2050. Madje, edhe sektori privat dhe publik në Japoni është i angazhuar në arritjen e këtij objekti. Mjedisi rrethues i ekonomisë qarkulluese ka ndryshuar mjaft brenda dy vitesh që nga miratimi i Vizionit të Ekonomisë Qarkulluese 2020 nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë.

Një akt i rëndësishëm për ekonominë qarkulluese të Japonisë është edhe Akti për Qarkullimin e Burimeve të Plastikës në Prill 2022. Japonia ishte shteti i dytë në botë për përdorimin e plastikës me një përdorim. Për këtë arsye, Japonia ka ndërmarrë hapa të mëdhenj në drejtim të riciklimit të plastikës.²⁷

Një tjetër teknik e përzgjedhur nga populli japonez për riciklimin e mbetjeve është edhe riciklimi i 80% të mbetjeve që prodhojnë qytetarët. Në qendër të qytetit të Kamikatsu ndodhet një

²⁴ <https://sweden.se/climate/sustainability/sweden-and-sustainability>

²⁵ Facing the future, Sustainability the Swedish way, Eva Krutmeijer, 2010.

²⁶ Innovation, the Swedish Way, Eva Krutmeijer, 2013.

²⁷ <https://www.weforum.org/agenda/2022/11/is-regeneration-the-key-to-the-future-of-the-circular-economy/#:~:text=The%20Japanese%20government%20is%20committed,transition%20to%20a%20circular%20economy.>

bashkëqytetar i cili ndanë materialet në pjesë më të vogla me qëllim ripërdorimin e tyre në të ardhmen. Këto materiale ndahen në 45 kategori të veçanta për riciklim e tyre më pas në uzinën e qytetit.²⁸

ThredUP²⁹ - ka krijuar një përvojë moderne të rishitjes në një nga platformat më të mëdha në internet për veshje për gra dhe fëmijë. Përmes tregut të tij, kompania Amerikane ThredUP ka krijuar një mënyrë më të zgjuar dhe më të lehtë për të blerë dhe shitur veshje të dorës së dytë. Shitësit e ThredUP dërgojnë rroba nga çdo markë falas dhe pastaj përpunon këto artikuj, duke kryer inspektime mbi cilësinë, bën analizë të çmimeve dhe të ruajtjes në mënyrë që ato të rishiten. Blerësit e ThredUP gëzojnë qasje në një shumëllojshmëri gjithnjë në ndryshim të rrobave me cilësi të lartë dhe çmim të ulët nga më shumë se 35,000 marka. Mbajtja e rrobave në përdorim për aq gjatë sa të jetë e mundur është në qendër të strategjisë së ekonomisë qarkulluese për modën. Analiza mbi ndikimin pozitiv në mjedis të ri-tregtimit tregon për përfitime në të gjithë spektrin e burimeve. Sipas vlerësimeve të ThredUP nëse të gjithë në SHBA do të blinin një artikull të përdorur në vend të një artikulli të ri në 2020 do të kurseheshin 3.6 milion ton CO₂ (66 milion pemë të mbjella), 100 miliardë litra ujë (dushe 1.25B), 200 milion kilogramë mbeturina (18,700 kamionë plehrash të plotë). Shkalla e ulët e ripërdorimit të rrobave jo vetëm që ndikon në mjedis, por edhe në ekonomi. Globalisht, klientët humbasin 460 miliardë dollarë me vlerë në rrobat që hedhin.

Të njëjtin qëllim me ThredUp kanë edhe disa zinxhirë dyqanesh në SHBA të cilat pranojnë të tregtojnë veshje të dorës së dytë ndër të cilat mund të përmendim: Goodwill dhe Buffalo Exchange. Edhe këto subjekte pranojnë të shesin veshjet e dorës së dytë me një çmim të arsyeshëm.

Nga ana tjetër, ekzistojnë edhe disa biznese të vogla të cilat pranojnë të tregtojnë vetëm veshje të cilat janë prodhuar me fibra të ricikluara ndër të cilat mund të përmendim: Patagonia dhe Ooloop.³⁰

²⁸ <https://greencoast.org/environmental-issues-in-japan/>

²⁹ <https://www.thredup.com/>

³⁰ <https://www.greenamerica.org/unraveling-fashion-industry/what-really-happens-unwanted-clothes#:~:text=On%20average%2C%20700%2C000%20tons%20of,tons%20get%20sent%20to%20landfills.>

Problemi kryesor për sa i përket veshjeve lidhet me faktin se ne si fillim prodhojmë shumë veshje. Në këtë kuptim, disa hapa që këshillohen të ndiqen me qëllim rritjen e jetëgjatësisë së veshjeve si një nga problematikat e botës moderne janë:

1. Reduktimi i blerjes së veshjeve të reja duke mbajtur parasysh pasojat që do të kenë ato mbi mjedisin. Sugjerohet që veshjet të jepen për donacion dhe jo të hidhen në landfille.
2. Kur vendosim të blejmë veshje të zgjedhim ato të dorës së dytë të cilat mund të gjenden si në dyqane fizike ashtu edhe online.
3. Kur bëjmë blerje të preferojmë ato produktet që kanë përmbajtje të ricikluar duke bërë kështu që të rritet kërkesa për produktet e ricikluara dhe duke nxitur kompanitë që të ripërpunojnë tekstilet e përdorura.³¹

Call2Recycle – është një program i cili merrë bateritë pasi ato janë përdoruar dhe i riciklon ato duke ofruar kështu një shërbim publik në SHBA. Call2Recycle ofron alternativa të përshtatshme riciklimi për bateritë e vjetra. Pavarësisht nëse konsumatori mund të ketë vetëm disa bateri apo edhe nëse ka sasi të konsiderueshme të baterive, edhe nëse dëshiron ta përfitojë shërbimin vetëm një herë apo në mënyrë të vazhdueshme, Call2Recycle e ofron shërbimin për këdo. Alternativat e riciklimit që ofrohen nga kjo kompani janë të shumta duke përfshirë kategori të ndryshme baterish duke përfshirë edhe bateritë me një përdorim, bateritë e rikarikueshme (përgjithësisht bateritë e telefonëve) dhe bateritë e dëmtuara.³²

Asgjësimi i baterive të automjeteve është aq e lehtë sa ta kthesh automjetin në dyqanin e automjeteve. Madje, edhe prodhuesit e telefonëve celular i kanë lënë mundësinë konsumatorëve që t'i kthejnë telefonët për riciklim. Përpara ndalimit të elementit të mërkurit në vitin 1996 në bateritë alkaline me një përdorim, procedurat e duhura të riciklimit ishin të detyrueshme.³³

Willow – është një kompani e vendosur në Mbretërinë e Bashkuar e cila realizon libra për fëmijë, por ajo që i bën këta libra të veçantë është se ata janë plotësisht miqësor ndaj mjedisit në shumë drejtime. Kjo kompani furnizohet tërësisht me energji të rinovueshme; letra që përdoret për

³¹ <https://www.greenamerica.org/unraveling-fashion-industry/what-really-happens-unwanted-clothes#:~:text=On%20average%2C%20700%2C000%20tons%20of,tons%20get%20sent%20to%20landfills.>

³² <https://www.nrrarecycles.org/resource-library/call2recycle-battery-recycling>

³³ <https://gsiwaste.com/battery-recycling-is-important-for-environmental-health/#:~:text=As%20batteries%20corrode%2C%20their%20chemicals,could%20be%20ingesting%20dangerous%20metals.>

prodhimin e librave është e ricikluar nga mbetjet e shkollave dhe të bizneseve; mospërdorimi i plastikës në asnjë nga proceset ku edhe qepja e librit bëhet me fije pambuku; boja që përdoret për shkrimin e librit është me bazë perimesh.³⁴ Megjithatë, ajo që i bën akoma më të veçantë këta libra është fakti se ata mund të mbillen. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet farave të cilat përdoren në krijimin e këtyre librave. Një tjetër element interesant i kësaj kompanie është edhe fakti se edhe përmbajtja e librit ka si qëllim edukimin mjedisor të fëmijëve.³⁵

Programi Rajonal i Brukselit për një Ekonomi Qarkulluese³⁶ – është nisma qendrore e Brukselit për ekonominë qarkulluese, nga e cila burojnë të gjitha aktivitetet e tjera të ekonomisë qarkulluese. Ky projekt është hartuar për të shfrytëzuar mundësitë e paraqitura nga një ekonomi qarkulluese, duke përfshirë pajtimin e objektivave ekonomike dhe mjedisore, mbështetjen e prodhimit lokal, optimizimin e përdorimit të tokës dhe integrimin e kërkesave të transportit. Shtytësit kryesorë ishin dëshirat për të stimuluar veprimtarinë inovative ekonomike, për të krijuar vende të reja pune dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për qytetarët e Brukselit.

Në vitet e para të krijimit: u trajnuan dhe u mbështetën më shumë se 220 kompani në zbatimin e qasjeve të ekonomisë qarkulluese, 8.3 milionë euro u janë dhënë 139 bizneseve ose projekteve kërkimore, janë trajnuar mbi 1,400 individë, u vendos bashkëpunim midis agjencive publike dhe ndërmarrjeve.

Ky projekt u fillua në vitin 2016 dhe janë të përfshira katër agjenci dhe tre institucione qeveritare. Përmes thirrjeve ajo ofron mbështetje financiare, marketingu apo këshillimi për projektet e ekonomisë qarkulluese të sipërmarrjeve, që janë teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme, dhe të dobishme për punësimin lokal. Thirrjet vjetore për projekte përfshijnë një buxhet prej përafërsisht 1.5 milion euro për ata që plotësojnë kriteret. Projektet e mbështetura në dy vitet e para ishin 60.

Praktika pozitive në Shqipëri

I.N.C.A. NORDFISH Sh.p.k – u themelua në vitin 2004 në qytetin e Lezhës. Ajo është e vetmja kompani në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit, që prodhon dhe shet zorrë të përpunuar dhe produkte

³⁴ <https://willsow.com/what-makes-willsow-special/>

³⁵ <https://willsow.com/welcome-to-willsow/>

³⁶ <https://circlelab.com/knowledge-hub/3440/brussels-regional-program-circular-economy-2016-2020-brpce>

me origjinë shtazore nën markën tregtare “INCA: Natural Casings”. Kjo kompani furnizon kompanitë më të mëdha shqiptare të mishit. Për më tepër, eksporton në vendet e Ballkanit dhe më gjerë. Një sasi e konsiderueshme e fitimit të kompanisë riinvestohet rregullisht në blerjen e pajisjeve moderne. Si pasojë, nga viti në vit vëllimi i produkteve të saj po rritet. Kompania operon me kapacitet të plotë me numrin e të punësuarve 110, me planin e zgjerimit për të dyfishuar kapacitetin aktual.

Për shkak të natyrës shumë delikate të zorrëve të kafshëve (p.sh. nganjëherë atyre u mungon madhësia e duhur sipas standardeve të klientëve të huaj, nganjëherë ato kanë vrima që i bëjnë ata të mos jenë të dobishëm për procesin e prodhimit), kompania ishte e detyruar t’i “hidhte”. Kjo shkaktonte dëm ekonomik. Në këto rrethana, pronari dhe djali i tij i madh që është diplomuar në biznes ndërkombëtar në Gjermani, vendosën të udhëtojnë në Evropë dhe të shohin se si menaxhohen këto shqetësime nga bizneset e tjera që operojnë në të njëjtën industri. Ata u njohën me praktikat më të mira në Evropë, por duheshin investime të reja teknologjike për të sjellë këtë ide të vërtetë në Shqipëri. Nëpërmjet investimeve teknologjike, kompania grumbullonte 80% të humbjeve nga të brendshmet e kafshëve dhe i përdorte për të prodhuar një produkt të ri krejt tjetër: ushqim për kafshët. Këto produkte finale kompania i eksporton në Belgjikë.

GER.ARD. Shpk – është themeluar në vitin 1999. Kohët e fundit, kompania është përqendruar në shërbimet e çmontimit të automjeteve të përdorura, pjesë këmbimi për makina dhe gjithashtu, import dhe eksport. Kompania zotëron pajisjet e nevojshme dhe teknologjinë e fundit për të siguruar çmontimin e plotë të makinave të vjetra. Demontimi kryhet në ambientet e tyre. GER.ARD. Shpk ka filluar partneritetin me IB Recycling, e cila është një kompani riciklimi që ofron shërbimet e saj për disa vjet në fushën e riciklimit të pjesëve të automjeteve dhe pjesë të ndryshme katalitike të produkteve elektronike. Kompania merret me përpunimin e skrapit elektronik dhe të gjitha mbeturinave të pajisjeve elektronike. Kompania ka në zotërim një infrastrukturë të përshtatshme për shërbimet e riciklimit. IB Recycling është përqendruar për të siguruar riciklimin e plotë të pjesëve të ndryshme të makinës për t’i kthyer ato në materiale prodhuese. Pajisjet kompjuterike dhe katalizatorët e shkarkimit të makinave, pjesë të ndryshme të makinave riciklohen me efikasitet në një nga strukturat më moderne në vend për riciklimin e këtyre produkteve. Aktualisht, kompania ka 20 të punësuar. Partneriteti i biznesit kërkon t’i zhvendosë ato në një nivel tjetër të të bërit biznes.

Sipas përshkrimit të mësipërm, GER.ARD. Shpk është më i përqendruar në çmontimin e automjeteve ndërsa të gjitha mbeturinat mbështeten në IB Recycling të cilat kryejnë procesin e riciklimit. Kompanitë i shesin produktet e ricikluara në Itali, Zvicër dhe Gjermani me rreth 80 tonë në vit.

Sapun Organik i Roskovecit

Roskoveci është një qytet i vogël i cili ndodhet në pjesën jug-qendrore të Shqipërisë. Situata socio-ekonomike e qytetit mbetet problematike. Karakterizohet nga një nivel i lartë papunësie, veçanërisht për gratë. Roskoveci është shumë i pasur me ullinj të cilët familjet kryesisht i përdorin për nevoja të tyre personale dhe për treg. Sidoqoftë, nga përgatitja e vajit të ullirit, krijohen shumë mbetje.

Projekti i titulluar “Sapun Organik i Roskovecit”, filloi në vitin 2018 dhe vazhdon të zbatohet. Bashkia e Roskovecit ka siguruar ambiente falas dhe ato u bën qendra e projektit. Ky projekt, i cili përdor mbetjet e vajit të ullirit nga fabrikat lokale të prodhimit ose nga ai vaj ulliri që nuk është për konsum, por mund të ripërdoret për të prodhuar sapun. Kjo punishte ka punësuar tashmë 25 gra që jetojnë në Roskovec. Këto punonjëse, përveç përdorimit të mbetjeve të vajit të ullirit, paketojnë të gjithë sapunët organik në një mënyrë shumë efektive. Ato përdorin një përzierje letre të ricikluar duke i dhënë kështu sapunit një pamje artizanale. Aktualisht, qendra është në gjendje të prodhojë një ton në muaj. Sidoqoftë, aftësia e prodhimit varet nga kërkesa e tregut.

Rinora – Tregut po i shtohen biznese të reja në këtë fushë si Rinora, e cila prodhon sapunin nga mbetjet e ullirit dhe sfungjer bimor luffa. Paketimi i produkteve realizohet me materiale të riciklueshme dhe të ripërdorshme³⁷.

³⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=MbHXOHir-Ig>

Ekonomia e gjelbër

5.1 Ekonomia e gjelbër dhe konceptet mbi të

Termi ekonomi e gjelbër përdoret për atë formë të ekonomisë, që ka në bazë zvogëlimin e problemeve mjedisore dhe që synon zhvillimin e qëndrueshëm pa dëmtuar mjedisin. Një tipar që e dallon atë nga regjimet e tjera ekonomike është vlerësimi i drejtpërdrejtë i kapitalit natyror dhe shërbimeve ekologjike si vlerë ekonomike. Aktualisht në shumë degë të industrisë janë intensifikuar tendencat për të zbatuar këto standarde, si një mënyrë efikase për të promovuar praktikatat e gjelbëra në ekonominë globale.

Qëllimi i Ekonomisë së Gjelbër është të krijojë një ekonomi të qëndrueshme, që përdor burimet natyrore në mënyrë efikase dhe ka më pak ndikim në mjedis, duke zhvilluar modele të reja, të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit për të siguruar prosperitet dhe një cilësi të lartë të jetës për brezat e ardhshëm. Kalimi në një ekonomi të gjelbër përfshin një kalim në prodhimin dhe konsumin e gjelbër; zvogëlimi i shterimit të burimeve natyrore dhe degradimi i ekosistemeve të shkaktuara nga aktiviteti ekonomik dhe rritja e furnizimit me energji "të pastër", me karbon të ulët duke kontribuar në zbutjen e ndryshimit të klimës.

Zhvillimi i ekonomisë së gjelbër lidhet me qëllimet e Traktatit të Gjelbër të Bashkimit Evropian dhe ka një qëllim të qartë – Evropa klimatike neutrale dhe më elastike deri në vitin 2050. Kalimi në një ekonomi të gjelbër kërkon:

- Dekarbonizimin e sektorit të energjisë dhe siguri;
- Ndërtim me efikasitet energjetik i ndërtesave të reja dhe rindërtim të ndërtesave ekzistuese;
- Industri inovative (mobilizimi i industrisë për ekonominë rrethore);
- Transport i mençur;
- Mjedis i pastër dhe jo toksik;
- Prodhimi i produkteve të gjelbër;
- Dizajn i gjelbër;
- Përdorimi i teknologjisë së gjelbër;
- Marketing të gjelbër;
- Orientimi i njerëzve, edukimi për të zgjedhur produktet e ekonomisë së gjelbër;

- Zhvillimin e ekonomisë së gjelbër të biznesit të riciklimit;
- Zbatimi i prodhimit të gjelbër, duke ofruar produkte të gjelbër;
- Transformimi teknologjik i ndërmarrjeve për të krijuar biznesin e gjelbër.

5.2 Mekanizmat mbështetës të ekonomisë së gjelbër

Vizioni për një ekonomi të gjelbër është ai që ofron mirëqeniepër të gjithë brenda kufijve ekologjikë të planetit. Ai ndjek pesë parime kyçe, secila prej të cilave mbështetet në parime të rëndësishme të politikës ndërkombëtare, të cilat së bashku mund të udhëheqin reformën ekonomike në kontekste të ndryshme.

- Parimi i mirëqenies: një ekonomi e gjelbër u mundëson të gjithë njerëzve të krijojnë dhe të gëzojnë prosperitet.
- Parimi i drejtësisë: ekonomia e gjelbër promovon barazi brenda dhe ndërmjet brezave.
- Parimi i kufijve planetarë: ekonomia e gjelbër mbron, rikthen dhe investon në natyrë.
- Parimi i efikasitetit dhe mjaftueshmërisë: ekonomia e gjelbër është e orientuar për të mbështetur konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm. Një ekonomi e gjelbër gjithëpërfshirëse është me karbon të ulët, që ruan burimet, e larmishme. Ajo përfshin modele të reja të zhvillimit ekonomik që adresojnë sfidën e krijimit të prosperitetit brenda kufijve planetarë.
- Parimi i qeverisjes së mirë: ekonomia e gjelbër udhëhiqet nga institucione të integruara, të përgjegjshme dhe elastike. Një ekonomi e gjelbër gjithëpërfshirëse bazohet në prova – normat dhe institucionet e saj janë ndërdisiplinore, përdorin shkencën dhe ekonominë e shëndoshë së bashku me njohuritë lokale për të hartuar strategji mbështetëse. Këtu përfshihen një spektër i gjerë i produkteve të huasë apo instrumenteve të tjera financiare, që mbështesin financimin e projekteve që nuk ndotin mjedisin, ose ndihmojnë për të minimizuar efektin mjedisor të projekteve të zakonshme të financimit. Më konkretisht, këtu përfshihen energjitë e rinovueshme dhe rritja e efikasitetit të energjisë, parandalimi apo kontrolli i mbrojtjes së mjedisit, ruajtja e biodiversitetit, nismat e ekonomisë qarkulluese, përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, etj.

Financa e gjelbër

Financa e gjelbër nënkupton krijimin e instrumenteve financiarë për mbështetjen e ekonomisë së gjelbër. Financimi i projekteve të reja në energjetikë ka qenë një ndër segmentet më dinamike në huadhënien e sektorit bankar në vitet e fundit.

- Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se portofoli i kredisë për kompanitë private të sektorit energjetik, në fund të muajit tetor 2021, kishte vlerën e 32 miliard lekëve, ose rreth 265 milion eurove. Ky portofol në 2021 është në rritje vjetore me pothuajse 32% dhe aktualisht ka prekur nivelet më të larta historike. Në harkun e tre viteve të fundit, vlera e portofolit në këtë sektor është dyfishuar, duke qenë një ndër aktivitetet ekonomike me rritjen më të shpejtë të aksesit në kreditim. Duke qenë se investimet në sektorin energjetik kanë qenë praktikisht të gjitha në profilin e energjive të rinovueshme, kryesisht hidrocentrale, por së fundmi edhe impiante fotovoltaike, mund të thuhet se financimi i këtyre projekteve përbën sot segmentin më të rëndësishëm të kredisë së gjelbër në Shqipëri. Rritja e këtij portofoli ka ndjekur ciklin e investimeve të rëndësishme të hidroenergjetikës në Shqipëri. Fillimisht, financimi i këtyre projekteve u prit me një lloj skepticizmi nga sistemi bankar, për shkak të përvojës së sektorit me projekte të tilla, por edhe nga mungesa e garancive të mjaftueshme të investitorëve.
- Në segmentin e individëve, segmenti kryesor i kredive të gjelbra është ai i lidhur me huatë për rritjen e eficiencës së energjisë. Këto kredi mundësojnë financimin e investimeve në produkte apo zgjidhje që mundësojnë kursimin e energjisë. Shembuj të tillë janë huatë për termoizolimim e banesave, ose për blerjen e paneleve diellore. Zakonisht, këto kredi kanë kushte tërheqëse financimi, si norma më të ulëta interesi me mbulim më të ulët kolaterali për klientët dhe mbështeten edhe me skema subvencionuese nga donatorë të huaj. Duke qenë se këto produkte janë të përfshira në portofolat e huave hipotekore dhe konsumatore, në nivel sistemi nuk ekzistojnë statistika të veçanta për vlerën e tyre totale, apo peshën specifike që mbajnë në portofola. Megjithatë, sipas bankierëve, përdorimi i këtyre kredive është në rritje.
- Një nga shembujt e përfitimeve direkte është skema GEFF e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në bashkëpunim me disa banka tregtare në Shqipëri. Kjo skemë i mundëson klientit rimbursim të 20% të shumës së investuar me qëllim rritjen e eficiencës së energjisë. Nga skema mund të përfitohet për investimet, që huamarrësi kryen në mënyrë direkte, por edhe në blerjen e një pasurie të paluajtshme, që plotëson kriteret e kërkuara të eficiencës energjetike. Edhe në rast se investimi është bërë nga ndërtuesi, qytetarit që e blen pronën me kredi i rimbursohet përqindja përkatëse e investimit të kryer për këtë qëllim. “Për investimet që kryhen me financimin e kredisë së gjelbër GEFF, klientët marrin një rimbursim nga BE në vlerën deri në 20% të shumës së financuar me kredi. Nga ana tjetër, me përdorimin e

produkteve që ofrojnë efikasitet energjetik për përdoruesin, vetë përdoruesi kursen në harkun afatgjatë në pagesa të energjisë elektrike krahasimisht me përdorimin e një pajisje që nuk është certifikuar në këtë aspekt. Për grupet e individëve, apo ndërtesat shumëkatëshe të banimit, skema parashikon mbulimin e 25% të kostove të pranueshme për një nënprojekt të ndërtesave të banimit shumëkatëshe, që përfshin një kategori të vetme të teknologjive, ose 35% të kostove të pranueshme për një nënprojekt të ndërtesave të banimit shumëkatëshe, me paketa me më shumë se një kategori të teknologjive.

- Investimet e lidhura me eficiencën e energjisë po përdoren gjithnjë e më shumë edhe nga bizneset, për nevojat e aktiviteteve të tyre. Një nga produktet më të përdorura në vitet e fundit janë impiantet fotovoltaike, me qëllim shfrytëzimin e energjisë diellore për të prodhuar energji elektrike. “Intesa Sanpaolo Bank Albania ofron zgjidhje të specializuara për financimin e sistemeve fotovoltaike për vetëprodhim, duke synuar të gjitha segmentet e biznesit nga Korporatat e Mëdha, e deri te Bizneset e Mesme dhe të Vogla (SME).
- “Green bonds”, alternativë për financimin e projekteve të mëdha – Ndër instrumentet më të rëndësishme të lidhura me financën e gjelbër sot janë edhe green bonds, apo obligacionet e gjelbra. Këto janë instrumente borxhi që emetohen me qëllim mbështetjen e projekteve me ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në mbrojtjen e mjedisit. Ato mund të financojnë projekte që synojnë efikasitetin e energjisë, parandalimin e ndotjes, bujqësinë e qëndrueshme, peshkimin dhe pylltarinë, mbrojtjen e ekosistemeve ujore dhe tokësore, transportin e pastër, ujin e pastër dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujit. Ata gjithashtu financojnë kultivimin e teknologjive miqësore me mjedisin dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Obligacionet e gjelbra shpesh shoqërohen me stimuj tatimorë, si përjashtimi nga taksat, duke i bërë ato një investim më tërheqës për investitorët në krahasim me një obligacion të zakonshëm. Për 2020, Shtetet e Bashkuara ishin emetuesi më i madh, me 50 miliard dollarë emetime të reja, ndërsa mes shteteve emetues të mëdhenj janë edhe Gjermania, Kina, Kanadaja, Franca, Holanda, Suedia, etj. Këtë vit, Serbia u bë vendi i parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që emetoi një green bond me maturim 7-vjeçar në vlerën e 1 miliard eurove, të siguruara me një kupon prej 1% dhe një yield prej 1.26%. Megjithatë, përveçse nga qeveritë, obligacionet e gjelbra emetohen në vlera të mëdha prej më shumë se një dekadë edhe nga bankat e zhvillimit dhe nga kompani private. Një shembull projekti konkret, që në teori mund të financohet nëpërmjet Green

Bonds, është Hidrocentrali i Skavicës, për të cilin qeveria shqiptare ka lidhur kontratë me firmën amerikane Bechtel.

5.3 Praktika pozitive të ekonomisë së gjelbër

- Lideri i industrisë së pijeve Coca-Cola vendosi në vitin 2009 të ul nivelin e paketimit të produkteve. Si rezultat i kësaj nisme ajo kurseu rreth 100 milion dollarë.
- Banka e Amerikës reduktoi peshën e faturave të saj në ATM nga 20 paund në 15 paund. Kjo jo vetëm që u kurseu atyre kostot e letrës, transportit, ruajtjes dhe trajtimit – por edhe 500,000 dollarë në vit.
- Dow Chemicals llogariti se me 2 miliard dollarë investime në energji të rinovueshme, kursen 9 miliard dollarë në kosto të reduktuara të energjisë.
- Shitësi i madh britanik me pakicë shumëkombëshe Marks & Spencer fitoi 50 milionë paund shtesë të ardhura pasi përqafoi udhëzimet e reja mjedisore.
- Duke shpresuar për të reduktuar produktet e mbeturinave dhe konsumin e energjisë, General Electric rriti buxhetin e saj të kërkimit dhe zhvillimit në kuadër të energjisë së gjelbër në 2005 në 1.5 miliard dollarë.
- Coca-Cola Bottling Albania³⁸ ka realizuar një investimi total prej 1,050,000 € për përdorimin e Paneleve të Energjisë Diellore – Fotovoltaikë, me synimin për të reduktuar emetimin shtesë të CO₂, çdo vit dhe për të mbuluar konsumin vjetor të energjisë në një nivel prej 62%, nëpërmjet përdorimit të burimeve natyrore për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja. Iniciativa do të sjellë reduktimin e emetimit të CO₂ = 1,230 ton/në vit dhe sipërfaqja, që do të mbulohet me panele diellore do të jetë mbi 10.680 m². Nisma vjen në kuadër të nismave të tjera të ndërmarra nga kompania, si vendosja e impiantit të filtrimit të ujit deri tek zëvendësimi i automjeteve të flotës së shitjes me ato 100% elektrike. Gjithashtu, Uji i Ftohtë Tepelene investoi edhe në sistemin e paneleve fotovoltaike, duke mbuluar 3221 m² me panele fotovoltaike, duke mundësuar 60,9% të nevojës për konsum, duke ulur 366 ton emetim CO₂, ekuivalente me punën e bërë nga 10,576 pemë çdo vit. Investimi total i Uji i Ftohtë Tepelens për sistemin energjetik fotovoltaik është 360,000 €.

³⁸<https://ccbs.al/en/pergjegjesia-sociale/investim-fotovoltaiik-ne-misionin-e-gjelber-te-ccbs/#:~:text=10%2C680%20m2%20of%20surface%20are,the%20most%20environmentally%20friendly%20technology.>

- Në Suedi numri i automjeteve të reja miqësore ndaj mjedisit të blera në vitin 2009 përbënte rreth 38% të totalit duke treguar një trend në rritje për zgjedhjen e automjeteve që janë miqësore ndaj mjedisit. Në këtë drejtim, edhe transporti ka pësuar ndryshime me qëllim përshtatjen e tij për ta bërë më miqësore ndaj mjedisit. Kështu, në Karlshamn, këshilli përdorë biçikleta elektrike për të bërë transportin atëherë kur është e nevojshme. Kjo shihet se ka dy efekte pozitive: *së pari*, është më miqësore ndaj mjedisit dhe *së dyti*, përbën më pak rrezikshmëri për fëmijët e shkollave dhe banorët e zonës.³⁹
- Suedia është një nga shtetet me politikat më ambicioze në drejtim të ekonomisë globale. Ajo ka qenë e para që ka vendosur një taksë gjithëpërfshirëse për karbonin, e vendosur kjo në vitin 1991; ka subvencionuar automjetet elektrike që nga viti 2006; dhe arriti objektivin e saj të 2020 për 50% të energjisë elektrike të rinovueshme tetë vite më herët nga sa ishte parashikuar. Edhe përgjigja e Suedisë ndaj COVID 19 ishte dyfishimi i përpjekjeve për ndërtimin e një ekonomie më të gjelbër, më elastike dhe gjithëpërfshirëse.⁴⁰
- Një tjetër element që e bën Suedinë një nga shtetet më miqësore ndaj mjedisit dhe të orientuara drejt një ekonomie të gjelbër është edhe fakti se një pjesë e mirë e suedezëve kanë zgjedhur të realizojë ngrohjen e tyre gjatë dimrit nëpërmjet një sistemi qendror ngrohje⁴¹ dhe jo nëpërmjet djegies së resurseve. Aq më tepër që kjo merrë rëndësi të veçantë në rastin e Suedisë ku temperaturat në stinën e dimrit janë mjaft të ulta dhe nevoja e ngrohjes është shumë e madhe.
- Plastika e degradueshme është plastika që degradohet në mënyrë biologjike. Disa lloje të plastikës së degradueshme janë të dekompozueshme, por jo të gjitha. Këto lloje të plastikës mund të dekompozohen në kushte të kontrolluara. Disa lloje të tjera mund të dekompozohen në kushte të caktuara specifike dhe të testuara, por pjesa më e madhe mund të dekompozohen vetëm në kushte industriale dekompozimi. Ato mund të dekompozohen edhe në mjedis, por koha që ky proces mund të marri është e ndryshme. Megjithatë, vlenë për t'u theksuar fakti se plastika e degradueshme nuk duhet të konsiderohet si zëvendësuesi i plastikës tradicionale,

³⁹ <https://sweden.se/climate/sustainability/sweden-and-sustainability>

⁴⁰ <https://greeneconomytracker.org/country/sweden#:~:text=Sweden%20is%20a%20leader%20in,Council%20review%20of%20government%20spending.>

⁴¹ Ngrohja me sistem qendror mund të konsiderohet si një sistem për ngrohjen që realizohet nëpërmjet ujit të nxehtë që kalon nëpër një rrjetë tubacionesh të vendosur në dyshemenë e banesave.

prandaj theksi vazhdon të vendoset në reduktimin e përdorimit të plastikës tradicionale. Përgjithësisht, plastika e degradueshme është e këshillueshme të përdoret për:

- qeset që përdoren për ndarjen e mbetjeve organike,
- enët e tavolinës që përdoren në organizime të cilat mund të mbahen në zona rurale ku mund të mos ketë elektricitet ose ujë për të bërë pastrimin e tyre,
- operacionet e ndihmës në rast fatkeqësie,
- kapsulat e kafes dhe bustinat e çajit,
- disa paketime të ushqimeve dhe perimeve.⁴²

Ndër shtetet që kanë orientuar preferencat në përdorimin e plastikës së degradueshme janë: Gjermania, Italia, Franca, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar.⁴³ Nga kjo mund të kuptohet se shtetet që preferojnë plastikën e degradueshme janë shtetet evropiane.

- I rëndësishme për t'u theksuar është fakti që pothuajse të gjithë shtetet kanë miratuar legjislacione të cilat parashikojnë sanksionimin me gjobë apo edhe me burg të individëve të cilët mund të ndërmarrin veprime që mund të dëmtojnë mjedisin. Natyrisht që kjo mund të konsiderohet si një hap i ndërmarrë nga shtetet me qëllim orientimin drejt një ekonomie të gjelbër në ndihmë të mjedisit.

⁴² <https://letsdoitfoundation.org/2020/09/04/what-are-biodegradable-plastics-the-need-for-a-clarified-terminology/>

⁴³ <https://www.globenewswire.com/en/news-release/2021/11/25/2341053/28124/en/Global-Biodegradable-Plastics-Market-2021-to-2026-High-Potential-in-Emerging-Countries-of-APAC-Presents-Opportunities.html#:~:text=Germany%2C%20Italy%2C%20France%2C%20Spain,the%20European%20biodegradable%20plastics%20market.>

Ndryshimet Klimatike dhe Kuadri Ligjor

6.1 Konferenca në Glasgow

Konferenca e 26-të e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, e mbajtur në Glasgow, nga 31 tetor deri më 13 nëntor 2021. Rezultati ishte marrëveshja e parë klimatike që u angazhua në mënyrë eksplicite për reduktimin e përdorimit të qymyrit. Ai përfshinte formulime që inkurajonin shkurtime më urgjente të emetimeve të gazeve serrë dhe premtinin më shumë financime klimatike për vendet në zhvillim për t'iu përshtatur ndikimeve klimatike.

Marrëveshjet e mëparshme nuk e kanë përmendur qymyrin, naftën ose gazin, apo edhe lëndët djegëse fosile në përgjithësi, si një nxitës ose shkaktar kryesor të ndryshimeve klimatike, duke e bërë Paktin e Klimës së Glasgow-t marrëveshjen e parë klimatike që planifikon në mënyrë eksplicite reduktimin e pandërprerë të energjisë së qymyrit.

Objektivat me arritjen e të cilave do të zvogëlohen efektet negative të ndryshimeve klimatike:

1. Me ndërmarrjen dhe financimin e veprimeve konkrete dhe të shpejta ngrohja globale të mbahet nën 1.5C.
2. Vendet e zhvilluara duhet ta zëvendësojnë energjinë e fituar nga qymyri sa më shpejt të jetë e mundur dhe të gjitha vendet në botë duhet të angazhohen që të mos hapin ose financojnë termocentrale të reja me qymyr.
3. Vendeve në zhvillim tu ofrohet mbështetje më e madhe për sigurimin e energjisë së pastër për qytetarët e tyre.
4. Të mbrohen dhe shtohen sipërfaqet pyjore, sepse aktualisht çdo disa sekonda priten pyje me një sipërfaqe sa një fushë futbollli.
5. Të përdoren automjeteve me emetim zero, pra me energji “të gjelbër” dhe të pastër.
6. Të zvogëlohet ngarkesa me sëmundje të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Shqipëria, pjesëmarrëse në këtë konferencë ka dorëzuar Planin e saj Kombëtar për Klimën. Ai fokusohet në gatishmërinë e qeverisë shqiptare për një proces afatgjatë përshtatjeje ndaj ndryshimeve klimatike. Ky plan e rendit Shqipërinë mes 30 shteteve që po ndërtojnë qëndrueshmërinë e tyre klimatike përmes një Plani Kombëtar të Përshtatjes (NAP). NAP bëhet kështu dokumenti i parë zyrtar në nivel politikash që adreson nevojën për integrimin e ndryshimeve klimatike në të gjithë sektorët e prekur në Shqipëri.

6.2 Marrëveshja e Parisit dhe rëndësia e saj

Që nga ratifikimi i **Marrëveshjes së Parisit** 2015 në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara në Konferenca e Palëve për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), shumica e qeverive kombëtare kanë miratuar masat për të ulur emetimin e gazrave serrë (GES) në atmosferë, gjë që ka një ndikim mbi modelet industriale të secilit vend. Qeveria e Shqipërisë e ka nënshkruar dhe ratifikuar Marrëveshjen e Parisit.⁴⁴

Marrëveshja historike e Parisit në kornizën e UNFCCC ishte vendimtare sepse ishte hera e parë që qeveritë e botës pas 20 vitesh negociatash, në Konferencën e 21-të të Parisit për Ndryshimet Klimatike (COP21), ranë dakord për të dekarbonizuar ekonominë globale. Marrëveshja përcaktoi një kornizë për të kufizuar ngrohjen globale nën 2 °C dhe duke vazhduar përpjekjet për ta kufizuar atë në 1.5 °C deri në fund të shekullit. Qeveritë ranë dakord:

- një qëllim afatgjatë për të mbajtur rritjen e temperaturës mesatare globale në nën 2 °C mbi nivelet para-industriale;
- të synojë të kufizimin e rritjes në 1.5 °C, pasi kjo do të zvogëlonte ndjeshëm rreziqet dhe ndikimet e ndryshimit të klimës;
- mbi nevojën që shkarkimet globale të arrijnë pikun sa më shpejt të jetë e mundur, duke pranuar se kjo do të zgjasë më shumë për vendet në zhvillim;
- për të ndërmarrë reduktime të shpejta pas kësaj në përputhje me shkencën më të mirë të disponueshme, në mënyrë që të arrihet një ekuilibër midis shkarkimeve dhe heqjeve në gjysmën e dytë të shekullit.

⁴⁴ Analiza e politikave të ndryshimeve klimatike në Shqipëri

Si një kontribut në objektivat e marrëveshjes, vendet kanë paraqitur plane gjithëpërfshirëse kombëtare të veprimit për klimën (kontribute të përcaktuara në shkallë vendi, NDC). Këto nuk janë ende të mjaftueshme për të arritur objektivat e rëna dakord të temperaturës, por marrëveshja gjurmon rrugën për veprime të mëtejshme.

Në kuadër të Marrëveshjes së Parisit, vendi ynë ka hartuar dhe paraqitur Raportin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar (KKP) në vitin 2016. Detyrimet në kuadër të kësaj marrëveshjeje kërkojnë rishikimin e objektiveve për uljen e shkarkimeve çdo pesë vjet. Rishikimi dhe paraqitja e raportit të dytë të KKP-së për Shqipërinë gjatë vitit 2021, përcaktoi edhe objektivat e reja për uljen e shkarkimeve dhe marrjen e masave zbutëse ndaj ndryshimeve klimatike deri në vitin 2030 në masën 20.9% krahasuar me vitin 2016. KKP përmban në vetvete planin e masave për të ulur shkarkimet e gazeve serë sipas sektorëve.⁴⁵

Në nëntor të vitit 2015, Republika e Shqipërisë paraqiti KKP-në e saj të parë me angazhimin për të reduktuar me 11,5% shkarkimet e CO_2 gjatë periudhës 2016-2030, ndërsa rishikimi i vitit 2021 e rriti objektivin në 20.9% krahasuar me skenarin bazë, për të arritur një reduktim prej 708 kT CO_2 deri në vitin 2030.⁴⁶ Aktualisht, vendi po punon për Komunikimin e IV-t Kombëtar.⁴⁷

Në vitin 2019, Shqipëria miratoi Dokumentin Strategjik për Ndryshimet Klimatike dhe

Planin e Veprimit për Zbutjen. Janë identifikuar gjashtë prioritete strategjike (PS) të zbutjes: Garantimi i rritjes së qëndrueshme ekonomike

- Ngritja e një sistemi monitorimi, raportimi dhe verifikimi për GES
- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse dhe i bashkëpunimit ndërinstytucional
- Integrimi i ndryshimeve klimatike në planifikimin strategjik sektorial
- Përforcimi i ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit
- Harmonizimi me kuadrin e BE-së për ndryshimet klimatike

⁴⁵ Monitorimi i planit kombëtar të veprimit faqja 8

⁴⁶ Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar, (KKP) i rishikuar për Shqipërinë, 2021

⁴⁷ Po aty, fq.

6.3 Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm

Shqipëria dhe 192 shtete të tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara në shtator 2015, morën angazhimin për t'i dhënë fund varfërisë, për të zbutur krizën e klimës dhe për të luftuar padrejtësinë përmes Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ)⁴⁸. **Synimet e Objektivit 13, veprim për klimën⁴⁹ janë:** 1 Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit përshtatës të të gjitha vendeve ndaj rreziqeve që lidhen me klimën dhe katastrofat natyrore në të gjithë vendet.

2. Integrimi i masave për ndryshimin e klimës në politikat, strategjitë dhe planifikimin kombëtar.

3. Përmirësimi i edukimit, ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore e institucionale për zbutjen, përshtatjen, uljen e ndikimit të ndryshimit të klimës dhe paralajmërimin e hershëm.

3.a Zbatimi i angazhimit të marrë përsipër nga vendet e zhvilluara që janë palë në Konventën

Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, me qëllim mobilizimin bashkërisht të 100 miliardë dollarëve në vit deri në vitin 2020 nga të gjitha burimet, për të trajtuar nevojat e vendeve në zhvillim në kuadrin e veprimeve mundësuese për zbutje dhe transparencë në zbatimin dhe funksionalizimin e plotë të Fondit të Klimës së Gjelbër nëpërmjet kapitalizimit të saj sa më shpejt që të jetë e mundur.

3.b Promovimi i mekanizmave për ngritjen e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim efektiv lidhur me ndryshimet klimatike në vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim, duke u përqendruar tek gratë, të rinjtë dhe komunitetet lokale dhe të marginalizuara.

6.4 Krijimi i një pakete instrumentesh për integrim përshtatës ndaj Ndryshimeve Klimatike

Ky veprim prioritar që kryeson Planin e veprimtarive prioritare të SK për NK do të duhej të përfshinte:

- Thjerrën klimatike;
- Qëndrueshmërinë Klimatike;

⁴⁸ <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17994.pdf>

⁴⁹ <https://albania.un.org/sq/sdgs>

- Vlerësimin Strategjik Mjedisor, me ndjeshmëri klimatike;
- Treguesit e shpenzimeve klimatike.

Përmes tyre synohej të arrihej përfshirja e aktorëve dhe institucioneve të ndryshme drejt përmbushjes së detyrimeve kuadër të vendit ndaj Marrëveshjes së Parisit. Në këtë kontekst, duhen krijuar edhe instrumentet e sipër përmendur, realizimi i të cilave duket se sheh nga e ardhmja.⁵⁰Në bazë të neni 33 pika 4, ligji Nr.155/2020 duhet të krijohet Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (NDA), struktura dhe funksionimi i tij përcaktohen me vendim të Këshilli të Ministrave, me propozimin e ministrit, sepse pasja e një autoriteti i cila i ka detyrat dhe objektivat e përcaktuara do të ndihmojë në përshtatjen dhe konkretizimin e ligjit dhe strategjisë në mënyrë më konkrete. Prej asaj kohe dhe deri në fund të periudhës së monitoruar në këtë dokument nuk ka pasur asnjë proces vlerësimi apo rishikimi me qëllim përmirësimin e PKP.⁵¹

Grupi Ndërmintoror i Punës për Ndryshimet Klimatike, GNPNK është krijuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 155 datë 19 shkurt 2015. Sipas KKP së miratuar me VKM Nr. 762/2015, GNPNK do të duhej të ristrukturohej për t'iu përshtatur strukturës së qeverisë së re, pas reformës territoriale. Në përbërje të tij, marrin pjesë 15 ekspertë të nivelit teknik të linjës kryesore dhe synimi është koordinimi i të gjitha institucioneve të përfshira në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Roli i tij gjithashtu është të lehtësojë integrimin e ndryshimeve klimatike në planet e reja përkatëse, politikat, programet dhe aktivitetet ekzistuese. GNPNK kryesohet nga Zëvendës Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, pasi Ministria është pika qendrore në ushtrimin e detyrës, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike.⁵²

Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Shqipëri) iu drejtua disa herë me kërkesa edhe faqes zyrtare për botimet qeveritare (QBZ.al) për të siguruar vendimet për krijimin e GNPNK, por vendimet e referuara në disa prej raporteve të hartuara nga asistenca e huaj për Shqipërinë, si të lidhura me krijimin e GNPNK nuk u arrit të gjendeshin. Në komunikimin me MTM është konfirmuar mos funksioni i tij prej vitit 2018 e në vazhdim dhe nevoja për riaktivizimin e tij me qëllim adresimin institucional të masave që duhen marrë në kuadër të rishikimit të KKP. Aktualisht nga miratimi i ligjit “Për ndryshimet klimatike” nuk është krijuar ende një institucion kompetent i cili do të

⁵⁰ Plani Kombëtar për Përshtatjen (PKP) ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri. Kuadri për Procesin e Vendit, Qershor 2016

⁵¹ Po aty

⁵² Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimt të SKNK, 2020-2030, fq.17

ndërmarrë nismat dhe do të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga ligji dhe konventat e ratifikuara nga R.Sh.

6.5 Kuadri ligjor dhe aktet nënligjore që duhet të miratohen.

Shqipëria ka zhvilluar dhe zbatuar një numër të madh të politikave, strategjive, planeve, programeve, projekteve dhe masave që lidhen me përshtatjen. Vendi ka identifikuar masat prioritare të përshtatjes në:⁵³

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020;
- Komunikimin e Tretë Kombëtar; - Politikën Kombëtare për Ndryshimet klimatike dhe në SKNK;
- Planin e saj Kombëtar të Përshtatjes; Planin e Përshtatjes për Tiranën;
- Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2019-2023;
- Politikën Kombëtare për Pyjet 2019-2030; - Planin e Integruar Ndër-sektorial të zonës Tiranë-Durrës;
- Programin Kombëtar të Fondit të Gjellbër për Klimën, që u hartua sipas metodës me pjesëmarrje bazuar në dokumentet e mëparshme. Këto dokumente identifikojnë një numër shumë të madh të masave të përshtatjes.

Masat janë kategorizuar dhe përmbledhur në Kontributin Kombëtar të Pikësnyuar (KKP) i rishikuar për Shqipërinë⁵⁴

Ndërgjegjësimi për këtë rrezik të lartë është rritur gradualisht, duke u materializuar në nisma të reja ligjore siç ishte: miratimi i Ligjit për Ndryshimet Klimatike (2020); Ligji Nr. 28/2022 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; zbatimi i programeve përshtatëse; fuqizimi i kapaciteteve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe të përfshirjes së komuniteteve.

Nëse ndalojmë analizën në Ligjin për Ndryshimet Klimatike do të shohim që në objektivat e tij janë: zvogëlimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë; rritjen e aftësisë për t’u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike; të krijojë një kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe ndërinstytucional për ndërmarrjen e veprimeve ndaj klimës në nivel kombëtar në përputhje me

⁵³ Po aty, fq.15

⁵⁴ Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar, (KKP) i rishikuar për Shqipërinë, Tabelat 19-25, fq. 70

legjislacionin e BE-së për ndryshimet klimatike. Ligji e parashikon si një detyrim konkret, por rregullimin e lë në kompetencë të akteve specifike ligjore në këtë fushë. Aktet nënligjore duhet të miratohen brenda 4 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit 155/2020 nga Këshilli i Ministrave. Ndërkohë për krijimin e institucioneve kompetente për menaxhimin e ndryshimeve klimatike, kjo periudhë 4 vjeçare nuk është e përshtatshme krahasuar me emergjencën e situatës. Përveç kësaj duhet të miratohen rregulla të detajuara të performancës së emëtimit të CO₂ nga automjetet e reja për pasagjerë dhe automjetet e reja të lehta tregtare, të cilat përfshijnë:

- a) monitorimin dhe raportimin e të dhënave për regjistrimin e automjeteve të reja për pasagjerë për vlerësimin e reduktimit të shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e lehta;
- b) monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e reja për pasagjerë dhe nga automjetet e reja të lehta tregtare.

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë bazën ligjore për integrimin e politikave dhe për masa efektive që mundësojnë:

- a. plotësimin e detyrimeve të Shqipërisë ndaj Konventës për arritjen e objektivit final të saj, përmes nxitjes së reduktimit të shkarkimeve të GES dhe ruajtjes dhe rritjes së përthithësve dhe rezervuarëve të vendit;
- b. përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe/ose lokal;
- c. evidentimin e arritjeve të vendit në këto drejtime duke përdorur metodologji sipas modeleve të Konventës dhe të BE-së.

Ligji Nr.155/2022 “Për ndryshimet klimatike” është në përputhje dhe duke u përshtatur me direktivat e Bashkimit Europian, konkretisht me Direktivën 2003/87/EC-EU ETS, ku parashtrohet synimi i Komunitetit për të reduktuar emetimet e gazeve serrë në masën 8% deri më 2012 dhe rreth 70% në terma afatgjatë, krahasuar me nivelet e vitit 1990. Vlera prej 70% shpreh një ambicie të madhe, si dhe faktin se BE-ja e konsideron serioze çështjen e ngrohjes globale. Kjo ambicie, ndonëse në preambul, u sugjeron Vendeve Anëtare një zbatim të Direktivës nën dritën e arritjes së objektivit afatgjatë, gjithashtu shërben si një udhërrëfyes për vendet joantare.⁵⁵

Transporti rrugor dhe kryesisht shkarkimin e CO₂ nga automjetet, merr një rëndësi të veçantë për t’u rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave mbi “Masat lidhur mbi sigurimin e

⁵⁵ Marrë në http://ec.europa.eu/energy/efficiency/buildings/buildings_en.htm, shkarkuar më 29 gusht 2012

informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja” i cili hyri në fuqi në 01.01.2022 dhe saktëson që në pikën e parë të tij dy arsye kryesore pse u nevojiten informacioni konsumatorëve:

- a) që t’u mundësojë atyre të bëjnë një zgjedhje të bazuar në informacion;
- b) promovimin e blerjes ose të dhënies me qira të autoveturave, që përdorin më pak lëndë djegëse dhe, në këtë mënyrë, shkarkojnë më pak CO₂ në mjedis.

Në pikën e fundit të vendimit saktësohen dhe organet përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e kërkesave të këtij vendimi që janë:

- a) struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë dhe mbrojtjen e konsumatorit;
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) pranë ministrisë përgjegjëse për fushën e transportit.

Ajo që vihet re nga VKM-ja e më sipërme është mos saktësimi i detyrave dhe kompetencave që kanë strukturat e mësipërme. Gjithashtu shohim që qëllimi primar i kësaj VKM-je është *bërja e një zgjedhje bazuar në informacion*, por nuk ka një rregullim mbi informacionin teknik që duhet të përcjellin strukturat përkatëse kur promovojnë blerjen e automjeteve në mënyrë që të nxisin reduktimin e CO₂. Të njëjtat saktësime duhet të bëhen edhe për dy VKM-të vijuese, ende të pa miratuara, mbi monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO₂, për regjistrimin e automjeteve të reja për pasagjerët.

6.6 Rëndësia e krijimit të një strukture për Monitorimin Raportimin dhe Vlerësimin

Përballë problemeve të ndryshme mjedisore shtetit i duhet të veprojë sipas një politike të caktuar. Ajo që vlerësohet thelbësor është krijimi i sistemeve që identifikojnë jo vetëm prioritetet, planet e veprimit, por edhe që ndajnë përgjegjësitë lidhur me NK, si dhe mundësojnë thithjen e investimeve për NK.

Aktualisht nuk ekzistojnë protokollet e monitorimit dhe vlerësimit për të gjurmuar projektet dhe programet që lidhen me NK në nivel kombëtar, nuk ka një platformë të harmonizuar për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave për NK. Në përgjithësi, Monitorimi dhe Vlerësimi shihet në nivel të kufizuar dhe shtrohet nevoja për Monitorimi dhe Vlerësimi specifik dhe të fokusuar për klimën. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit duhet të miratojë vendimin për krijimin e Autoritetit

Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër (CDM) në kuadër të Protokollit të Kiotos. Domosdoshmëria e ngritjes së një sistemi MRV (monitorim, raportim dhe verifikim) bëhet me synimin për të rritur transparencën për përpjekjet që duhet të realizohen për zbutjen e ndryshimeve klimatike, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

6.6 Reduktimi i shkarkimeve të GES

Së pari kuptimi i GES përkufizohet nga ligji 155/2020, i cili parashikon se:

“Gaz me efekt serrë (GES) janë gazet që gjenden në atmosferë në gjendje natyrale dhe të shkaktuara nga aktivitetet antropogjene, të cilat përthithin dhe rriemetojnë rrezatimin infra të kuq”⁵⁶.

Për marrjen e masave konkrete për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike kërkohet një bashkëpunim i gjerë dhe mbështetja e publikut. Konkretisht duhet të miratohen aktet nënligjore për specifikimet teknike bazuar në nenin 13 pika 8 dhe neni 18 pika 4. Këto dispozita të ligjit kërkojnë një rregullim ligjor në lidhje me krijimin e rregulloreve për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të CO₂ nga anijet dhe avionët dhe rregullore për përlllogaritjen e shkarkimeve të GES-it dhe të përthithjes së tyre, që rezultojnë nga aktivitetet që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës e pyjeve, si dhe për informacione të tjera që lidhen me këto aktivitete të cilat duhet të miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për bujqësinë brenda 4 viteve.

Pavarësisht përshtatjes së legjislacionit me aktet ndërkombëtare përsëri një pjesë e madhe e akteve nënligjore që do të vihen në zbatim të ligjit nuk janë miratuar për shkak të elementëve kompleks që parashikon arritja e objektivave të përcaktuara në këtë ligj, periudha tranzitore për plotësimin me akte nënligjore e cila është mjaft e gjatë, katër vjet dhe një pjesë e akteve nënligjore që tashmë janë miratuar më parë, janë lënë ende në fuqi.

⁵⁶ Neni 3, pika 11 i ligjit 155/2020 “ Për ndryshimet klimatike”

Referencat:

- Ceka, Jonka. *Ndryshimi i Klimës dhe sfidat e Shqipërisë drejt europës në këndvështrim të së drejtës ndërkombëtare*. Universitet European i Tiranës. Tiranë, 2015.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. *Strategjia e ndryshimeve Klimatike dhe planet e veprimit*. Tiranë, 2019
- *Analiza e politikave të ndryshimeve klimatike në Shqipëri*. Universiteti i Tiranës, FEUT. Tiranë, 2021.
- *Monitorimi i planit kombëtar të veprimit, Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike 2020-2030*. Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri. Janar 2022
- Monitorimi i strategjisë kombëtare për ndryshimet klimatike, 2020 – 2030 për 2019 – 2021. Nëntor 2021
- Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar, (KKP) i rishikuar për Shqipërinë. 2021
- Plani Kombëtar për Përshtatjen (PKP) ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri. Kuadri për Procesin e Vendit. Qershor 2016
- Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar, (KKP) i rishikuar për Shqipërinë
- Haxhimali, Agron dhe Cacaj Aida, Shoqata e Bashkive. *Manual lokalizimi i axhendës 2030*, Gusht 2021
- Kola (Tafaj), F.; Vokshi, A. *Procedura Civile*. Pjesa I, Botimi II, Shtëpia Botuese: Albas, Tiranë, 2018, f. 300.
- *Facing the future, Sustainability the Swedish way*, Eva Krutmeijer, 2010.
- *Innovation, the Swedish Way*, Eva Krutmeijer, 2013.
- Lehmann et al., 2014; Fondacioni Ellen MacArthur, 2012.
- Ellen MacArthur, 2013.
- Eurostat, 2013.
- Të dhënat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shkurt 2022.
- Raporti i Bankës Botërore, 2017.
- Komisioni Evropian 2015
- Vendimi nr. 1177, datë 21.07.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 1259, datë 30.07.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 2066, datë 23.11.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- http://ec.europa.eu/energy/efficiency/buildings/buildings_en.html

- <https://iep-al.org/environmental-issues-in-albania/global-warming/?lang=sq>
- <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17994.pdf>
- <https://albania.un.org/sq/sdgs>
- <https://earth.org/what-is-fast-fashion/>
- <https://earth.org/fast-fashions-detrimental-effect-on-the-environment/#:~:text=The%20environmental%20impact%20of%20fast,amounts%20of%20öater%20and%20energy>
- <https://www.textilemountainfilm.com/about#:~:text=These%20low%2Dgrade%20textiles%20are%20burned%20or%20landfilled.&text=Sprawling%20over%2030%20acres%20just,residents%20%26%20businesses%20is%20dumped%20here>
- <https://gsiwaste.com/battery-recycling-is-important-for-environmental-health/#:~:text=As%20batteries%20corrode%2C%20their%20chemicals,could%20be%20ingesting%20dangerous%20metals>
- https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-01/C_2021_9730_F1_ANNEX_EN_V1_P1_1674669.PDF
- <https://www.circulairondernemen.nl/library/plastic-pact-nl-mr-met-minder-plastic-1>
- <https://sweden.se/climate/sustainability/sweden-and-sustainability>
- <https://www.weforum.org/agenda/2022/11/is-regeneration-the-key-to-the-future-of-the-circular-economy/#:~:text=The%20Japanese%20government%20is%20committed,transition%20to%20a%20circular%20economy>
- <https://greencoast.org/environmental-issues-in-japan/>
- <https://www.thredup.com/>
- <https://www.greenamerica.org/unraveling-fashion-industry/what-really-happens-unwanted-clothes#:~:text=On%20average%2C%20700%2C000%20tons%20of,tons%20get%20sent%20to%20landfills>
- <https://www.greenamerica.org/unraveling-fashion-industry/what-really-happens-unwanted-clothes#:~:text=On%20average%2C%20700%2C000%20tons%20of,tons%20get%20sent%20to%20landfills>
- <https://www.nrrarecycles.org/resource-library/call2recycle-battery-recycling>

- <https://gsiwaste.com/battery-recycling-is-important-for-environmental-health/#:~:text=As%20batteries%20corrode%2C%20their%20chemicals,could%20be%20ingesting%20dangerous%20metals>
- <https://willsow.com/what-makes-willsow-special/>
- <https://willsow.com/welcome-to-willsow/>
- <https://circlelab.com/knowledge-hub/3440/brussels-regional-program-circular-economy-2016-2020-brpce>
- <https://www.youtube.com/watch?v=MbHXOHir-Ig>
- <https://ccbs.al/en/pergjegjesia-sociale/investim-fotovoltaiq-ne-misionin-e-gjelber-te-ccbs/#:~:text=10%2C680%20m%20of%20surface%20are,the%20most%20environmentally%20friendly%20technology>
- <https://sweden.se/climate/sustainability/sweden-and-sustainability>
- <https://greeneconomytracker.org/country/sweden#:~:text=Sweden%20is%20a%20leader%20in,Council%20review%20of%20government%20spending>
- <https://letsdoitfoundation.org/2020/09/04/what-are-biodegradable-plastics-the-need-for-a-clarified-terminology/>
- <https://www.globenewswire.com/en/news-release/2021/11/25/2341053/28124/en/Global-Biodegradable-Plastics-Market-2021-to-2026-High-Potential-in-Emerging-Countries-of-APAC-Presents-Opportunities.html#:~:text=Germany%2C%20Italy%2C%20France%2C%20Spain,the%20European%20biodegradable%20plastics%20market>



Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al



KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR



AUTORË:

BUKURIE GJATA
KERIDA PASHAJ
KIARA MANJA
MAEND KULLAJ
SINDI ÇAUSHI

Ky material është punuar nga studentët, me mbështetjen e juristëve të CLE, në kuadër të projektit Tirana European Youth Capital, me mbështetje të Kongresit Rinor Kombtarë dhe Bashkisë Tiranë.